



HYRJE NË SISTEMIN SHQIPTAR TË FALIMENTIMIT



Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Përmbajtja

I. HYRJE	8
II. SI E KA NDRYSHUAR LF-ja SISTEMIN SHQIPTAR TË FALIMENTIMIT?	9
II.I. Analiza e objektivave dhe zbatimi i LF-së në krahasim me ligjin e vjetër për falimentimin 8901/2002.....	9
III. DUKE MENDUAR PËR PROCEDURAT E FALIMENTIMIT.....	14
III.I. Çfarë veprimesh mund të kryejë një person për të shmangur procedurat e falimentimit?.....	14
III.II. Duke menduar për procedurën e falimentimit: një përmbledhje e shkurtër se si të veprohet.....	16
IV. DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR SHPALLJEN FALIMENTIMIT	20
IV.I. Kërkësa për fillimin e procedurave të falimentimit nga kreditorët.....	20
IV.II. Kërkësa për fillimin e procedurës së falimentimit nga debitorët.....	25
V. EFEKTET E HAPJES SË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT.....	28
V.I. Efektet kryesore të Vendimit për Hapjen e Procedurave të Falimentimit	28
V.II. Paraqitja e pretendimeve nga Kreditorët	32
V.III. Publikimet dhe njoftimet.....	36
V.IV. Ndërhyrja e prokurorit në procedurat e falimentimit	37
VI. KUPTIMI I PROCEDURAVE TË FALIMENTIMIT DHE KARAKTERISTIKAT E TYRE KRYESORE	41
VI.I. Faza e përbashkët.....	41
VI.II. Faza e riorganizimit	43
VI.III. Riorganizimi i përsheptuar sipas LF-së	47
VI.IV. Faza e Likuidimit	48
VI.IV.I. Shkarkimi i debitorit nga detyrimet-Rifillimi	51
VI.V. Mbyllja e procedurave të falimentimit dhe afati kohor i veprimeve të kërkuara	52
VII. SHPJEGIME PËR MËNYRËN SE SI LIGJET E TJERA NDËRVEPROJNË ME LF-në	53
VII.I. Ligjet në lidhje me regjimet e përgjithshme të falimentimit	53
VII.I.I. Ligji për Shoqëritë Tregtare	53
VII.I.II. Legjislacioni tatimor	55
VII.I.III. Kodi i Procedurave Civile	55
VII.I.IV. Ligji për sistemin e pagesave	56
VII.II. Përgjashtimet nga regjimi i përgjithshëm i falimentimit	57
VII.III. Konkluzione	58

© Korporata Ndërkombëtare Financiare 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

2121 Pennsylvania Avenue, N.W.

Washington, D.C. 20433 Internet: www.ifc.org

Materiali mbrohet nga e drejta e autorit. Kopjimi dhe/ose transmetimi i pjesëve ose i gjithë këtij materiali pa leje mund të përbëjë shkelje të ligjit në fuqi. IFC nuk garanton saktësinë, besueshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së përfshirë në këtë material, ose për përfundimet ose gjykimet e përshkruara këtu, dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë lëshim ose gabim (përfshirë, pa kufizim, gabime tipografike dhe teknike) në çfarëdo përmbajtjeje ose për mbështetje në të.

Rreth IFC-së

IFC, një anëtare e Grupit të Bankës Botërore, është institucioni më i madh global i zhvillimit i përqendruar në sektorin privat në tregjet në zhvillim. Ne punojmë në më shumë se 100 vende, duke përdorur kapitalin, ekspertizën dhe ndikimin tonë për të krijuar tregje dhe mundësi në vendet në zhvillim. Në vitin fiskal 2021, ne kemi investuar një shumë rekord prej 31.5 miliardë dollarë në shoqëri private dhe institucione financiare në vendet në zhvillim, duke shfrytëzuar fuqinë e sektorit privat për t'i dhënë fund varfërisë ekstreme dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët ndërsa ekonomitë përballen me ndikimet e pandemisë COVID-19. Për më shumë informacion, vizitoni www.ifc.org.

RRETH AUTORËVE

KALO & ASSOCIATES (themeluar më 1994) është një zyrë ligjore e cila ofron shërbime ligjore në të gjitha aspektet e ligjit tregtar në Shqipëri dhe Kosovë, duke përfaqësuar shoqëri dhe agjenci të shquara, të huaja dhe ndërkombëtare, përfshirë disa Fortune 500, që bëjnë biznes në një spektër të gjerë të industrive në të gjithë globin, përfshirë rajonin e Ballkanit. Zyra punëson avokatë të kualifikuar dhe të përkushtuar me përvojë të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve ligjore të sofistikuar dhe komplekse dhe transaksione sipas standardeve ndërkombëtare, në mjedisin lokal. Zyra administron me sukses dhe në kohën e duhur çështje tregtare për shkak të departamenteve të strukturuar: 1) Shoqëritë tregtare (M&A dhe JV), 2) Shërbime bankare dhe financiare, 3) Projektet (koncesione dhe PPP) në fushat e energjisë & burimeve natyrore, 4) Pronësia intelektuale (përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale, etiketimin, shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale), 5) Punësimi & migracioni, dhe 6) Përfaqësimi në gjykatë, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. KALO & ASSOCIATES gëzon njohjen rajonale duke qenë një anëtar themelues i SEE LEGAL (South East European Legal Group), grupi drejtues rajonal i 10 zyrave ligjore, të cilat ofrojnë shërbime ligjore cilësore, duke përfshirë transaksione tregtare ndërkufitare në 12 juridiksione të SEE LEGAL që prej 2003.

ANDRÉS F. MARTÍNEZ është Specialist i Lartë në Sektorin Financiar në fushën e Falimentit dhe Zgjidhjes së Borxhit, pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin. Andrés është diplomuar në fushën e të drejtës në vitin 2000 dhe ka praktikuar ligjin e falimentit në një kompani të madhe ligjore në Argjentinë, që kur u pranua në dhomën e avokatëve (2001) deri në 2008, kur u bashkua me Grupin e Bankës Botërore. Ai ka drejtuar treguesin e “paaftësisë paguese” të “Doing Business” (të Bërit Biznes) të Grupit të Bankës Botërore deri në 2011 dhe që atëherë ka ofruar konsulencë në disa vende në lidhje me reformën në fushën e falimentit dhe zgjidhjes së borxhit, në Europën Lindore dhe Azinë Qendrore, Amerikën Latine, Azinë Lindore dhe Lindjen e Mesme. Në pozicionin e tij aktual, ai drejton dialogun me disa qeveri në lidhje me çështje teknike në fushën e zgjidhjes së borxhit dhe paaftësisë paguese.

SERGIO A. MURO punon si Konsulent në fushën e Falimentit dhe Zgjidhjes së Borxhit (me fokus tek falimenti dhe zbatimi i kontratës), pjesë e Praktikës Globale të Grupit të Bankës Botërore për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin. Që në 2016, ai ka ofruar konsulencë vendeve të ndryshme mbi reformën për zgjidhjen e borxhit, duke përfshirë sistemet e falimentit dhe rekuperimin e borxhit në Europën Lindore dhe Azinë Qendrore, Azinë Lindore, dhe Lindjen e Mesme. Përveç kësaj, ai drejton Projektin e Gjykatës së Lartë Argjentinase në Universidad Torcuato Di Tella, ku ai studion mënyrën si merren vendimet e Gjykatës së Lartë.

PROJEKTI DHE PËRBËRJA E GRUPIT

Menaxheri i Projektit | Igor Matijevic, është një Specialist i Lartë i Sektorit Financiar në Departamentin e Këshillimit për Krijimin e Tregjeve pranë Grupit të Bankës Botërore (IFC/ WBG), me eksperiencë prej 15 vitesh në këtë organizatë ndërkombëtare në disa shtete të Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA) me fokus kryesisht në Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, ai është Menaxher Rajonal i Projektit Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja e Biznesit.

në Ballkanin Perëndimor, në kuadër të së cilit organizon dhe lehtëson zbatimin e tij në pesë shtete (Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Kosovë, Maqedonia e Veriut dhe Serbi) nëpërmjet komunikimit dhe koordinimit me klientët qeveritar, agjencitë dhe institucionet, si dhe rrjetit të gjërë të palëve të interesit ndërkombëtar dhe lokal. Z. Matijevic zotëron dije të thella dhe eksperiencë në legjislacionin dhe zbatimin e zgjidhjes së borxhit, shoqëruar me një mirëkuptim të fortë në mundësimin e biznesit dhe në reformat e sektorit financiar.

Koordinatorja e Projektit Irena Gribizi, i është bashkuar IFC-së që në vitin 2001 dhe ka punuar si Drejtuese Operacionale për menaxhimin e disa projekteve në Shqipëri me fokus zhvillimin e sektorit privat. Nga viti 2012 znj. Gribizi, Profesioniste e Certifikuar në Menaxhim Projekti (PMP) është angazhuar si konsulente për IFC-në/Grupin e Bankës Botërore dhe në cilësinë e koordinatorës për Shqipëri ka drejtuar projektet për përmirësimin e klimës ku operon biznesi, ku mund të përmendim: Thjeshtësimi i Taksave dhe Transferimi i Çmimit, Logjistika Tregtare në Ballkanin Perëndimor, Klima e Investimeve dhe Konkureshmëria në Agrobiznes, Mbështetja për Lehtësimin e Tregtisë dhe Zgjidhja e Borxhit dhe Dalja nga Biznesi. Si pjesë e projektit të fundit, ajo ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në negociatat me klientët qeveritarë, në hartimet e propozimeve për projektin, në koordinimet e aktiviteteve në vend dhe në menaxhimin e gjithë ekipit lokal dhe të huaj për projektin. Znj. Gribizi ka mbështetur projektin veçanërisht në disa seminare të nivelit të lartë me zyrtarë të qeverisë, sikurse ka drejtuar me sukses procesin e hartimit të ligjit të ri për falimentin në Shqipëri.

Nën mbikqyrjen e: Damien Shiels, Menaxher i Praktikës (IFC AS), në Evropën Lindore & Azinë Qëndrore, Praktika Globale për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin dhe Mahesh Uttamchandani, Menaxher i Praktikës, EFNFI, Praktika Globale për Financat, Konkureshmërinë dhe Inovacionin.

LISTA E SHKURTIMEVE

LEK	Leku shqiptar
KPC	Kodi i Procedurës Civile
BSF	Bordi i Stabilitetit Financiar
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
LF	Ligji nr. 110/2016 për falimentimin
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
KK	Kredi të Këqija
SECO	Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike
UNCITRAL	Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Tregtisë Ndërkombëtare
UCITS	Ndërmarrjet për investime kolektive në letra me vlerë të transferueshme
UNIDROIT	Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private
WBG	Grupi i Bankës Botërore

I. HYRJE

Në kuadër të Fazës II të Projektit të Zgjidhjes së Borxhit, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore (WBG), me mbështetjen e Sekretariatit shtetëror zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), si aktiviteti i fundit i kësaj faze të projektit, kishte planifikuar përgatitjen e një shpjegimi të sistemit Shqiptar të falimentimit, për lehtësi referuar më tutje si “Komentari” i procedurave dhe proceseve të parashikuara nga ligji nr. 110/2016 “Për falimentimin” (“LF-ja”). Komentari^[1] synon të shpjegojë: si ka ndryshuar LF-ja sistemin e shqiptar të falimentimit; proceset e para të falimentimit; depozitimin e kërkesës për falimentim; efektet e fillimit të procedurave të falimentimit; kuptimin e procedurave të falimentimit dhe karakteristikat e tyre kryesore; shpjegimin se si ligjet e tjera ndikojnë në LF, etj.

Prandaj, ky Komentari ofron një mundësi për të njohur procedurat nga fillimi i tyre deri në fazën përfundimtare, qoftë ajo riorganizimi apo likuidimi i debitorit. Ky Komentari i ofron lexuesit një pikënisje për t'u njohur me sistemin shqiptar të falimentimit, por ai nuk është krijuar për të siguruar përshkrimin e plotë të sistemit, por për t'u thelluar në disa nga risitë kryesore, procedurat dhe mekanizmin e ofruar nga LF-ja^[2].

[1] Komentari, si çdo punim tjetër i projektit u përgatit nga studio shqiptare e avokatisë KALO & ASSOCIATES dhe përmban të dhëna gjithëpërfshirëse nga ekspertët ndërkombëtarë të WBG Andres Martinez dhe Sergio Muro.

[2] Projekti për Shlyerjen e Borxhit tashmë ka prodhuar manuale të tjera të rëndësishme si Manualët për Debitorët dhe Kreditorët; Rregulloret në lidhje me shpërblimin e administratorit të falimentimit/kujdestarit dhe standardet kombëtare për të vlerësuar pasurinë; Udhëzime për parimin e konfidencialitetit, transparencën dhe aksesin e publikut dhe për rolin e prokurorit në procedurat e falimentimit; Studimi i çështjeve gjyqësore të iniciuara nga debitorët; Analiza e efikasitetit të mekanizmave të rinj të paraqitura nga LF-ja, etj. Ky dokument i referohet gjerësisht disa prej këtyre dokumenteve. Analiza nuk ka për qëllim të ofrojë këshilla juridike të çfarëdo lloji. Subjektet ose individët e interesuar për këshilla ligjore duhet të kërkojnë ndihmën e duhur profesionale.

II. SI E KA NDRYSHUAR LF-ja SISTEMIN SHQIPTAR TË FALIMENTIMIT?

Shoqëritë përballen me shumë sfida gjatë ekzistencës së tyre. Këto sfida mund të jenë të brendshme, siç janë keq menaxhimi, problemet e likuiditetit, defektet në produktet e tyre, etj., ose të jashtme, siç janë ndryshimet në tendencat e tregut^[3], luftërat, pandemitë, rregulloret që kufizojnë ose vendosin sfida për industrinë ku vepron biznesi, rritja e konkurrencës ose vështirësitë makroekonomike (d.m.th. zhvlerësimi i monedhës), etj. Ndonjëherë, disa nga situatat e sipërpërmendura mund ta fusin një shoqëri në vështirësi të mëdha financiare. Kur vështirësitë financiare ose ekonomike prekin një debitor dhe e vendosin atë në *situatën e paaftësisë paguese*, vetë debitori ose kreditorët e tij mund t'u drejtohen *procedurave zyrtare gjyqësore të falimentimit*, të rregulluar nga LF-ja.

Më 22 maj 2017, LF-ja hyri në fuqi pikërisht për të rregulluar procedurat e falimentimit si për debitorët persona fizikë ashtu edhe për ata persona juridikë^[4]. Një nga objektivat kryesore të procedurave të falimentimit është të mundësojë që debitori dhe kreditorët e tij të gjejnë një zgjidhje kolektive në lidhje me paaftësinë e debitorit për të shlyer plotësisht kreditorët e tij ose, në të kundërt, të likuidohen pasuritë e debitorit dhe të shpërndahen të ardhurat nga to. Pas fillimit të këtyre procedurave, LF-ja përmban rregulla detyruese materiale dhe procedurale për mënyrën se si kreditorët dhe debitori i tyre i përbashkët duhet të punojnë së bashku për gjetjen e një zgjidhje për vetë paaftësinë paguese^[5]. LF-ja shprehet se qëllimi kryesor i një procedure falimentimi është shkarkimi kolektiv i detyrimeve të debitorit përmes riorganizimit të veprimtarisë ose likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes së të ardhurave.

II.1. Analiza e objektivave dhe zbatimi i LF-së në krahasim me ligjin e vjetër për falimentimin 8901/2002

Ligji i vjetër i falimentimit u konsiderua shumë kompleks dhe i vështirë për t'u zbatuar në mënyrë efektive në praktikë. Kjo u vërtetua pas krizës financiare globale, pas së cilës pavarësisht një raporti të kredive të këqija (KQ) prej rreth 25%, kishte raste të kufizuara falimentimi, përveç atyre të nisura nga autoriteti tatimor, zakonisht kundër shoqërive që kishin pasuri të pamjaftueshme për të mbuluar koston e procesit. Si pasojë, sistemi i vjetër nuk u përdor gjerësisht, dhe në ato raste kur është përdorur, ka pasur pak mundësi për të ruajtur vlerën e biznesit^[6]. LF-ja u hartua për të siguruar një sistem më të parashikueshëm që krijon një ekuilibër më të mirë midis të drejtave të debitorëve dhe kreditorëve gjatë procedurave gjyqësore në veçanti në lidhje me procedurat e riorganizimit dhe likuidimit, shpërblimin e administratorëve, ristrukturimin e borxhit dhe çështje të tjera të shpjeguara në këtë Seksion.

[3] Një nga shembujt tipikë është një shoqëri në industrinë e makinave të shkrimit në momentin e kalimit në epokën e kompjuterit.

[4] Shikoni Nenet 3.6 dhe 4 të LF-së.

[5] Më shumë mbi zgjidhjet tipike të paaftësisë paguese mund të gjenden më poshtë.

[6] Relacion i ligjit të ri të Falimentimit botuar nga Parlamenti.

Falimentimi i filluar nga autoritetet tatimore

Një nga çështjet kryesore të hasura gjatë viteve të zbatimit të ligjit të vjetër ishte keqkuptimi i krijuar me ligjin e procedurave tatimore. Në ato vite, shkaqet kryesore për fillimin e procedurave të falimentimit ishte mungesa e aktivitetit tregtar për më shumë se dy vjet, një status “pasiv” i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (“QKB”) për më shumë se dy vjet, deklarimi i humbjes së kapitalit për më shumë se tre vjet etj. Ligji i vjetër i falimentimit lidhte falimentimin me paaftësinë paguese ose mbingarkesat e borxhit, ndërsa ligji i tatimeve e lidhte falimentimin me situatën negative financiare të biznesit, e cila krijoi paqartësi në interpretim dhe bëri që autoritetet tatimore mos vepronin në përputhje me ligjin e falimentimit. Në fakt, “rreth 85%” e çështjeve të falimentimit në 2013 ishin filluar nga autoritetet tatimore për arsye që nuk buronin në mënyrë rigorozë nga ligji për falimentimin. Shumica e tyre u refuzuan për shkak të pasurive të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e procesit.^[7]

LF-ja e reformoi këtë qasje. LF-ja deklaroi se procedurat e përfshira në të qëndrojnë më lart krahasuar me procedurat e tjera të lidhura me falimentimin të parashikuara nga ligjet e tjera. Më saktësisht, LF-ja parashikoi që me hyrjen e tij në fuqi, neni 104 i ligjit të procedurave tatimore duhet të shfuqizohet. Për të përmbushur këtë kërkesë të LF-së, neni 104 i ligjit të procedurave tatimore u shfuqizua në nëntor 2016. Kjo ndërhyrje ligjore nuk e detyron më administratën tatimore të kërkojë hapjen e procedurave të falimentimit.

Shpërblimi dhe trajtimi i administratorëve të falimentimit

Është pranuar se përvoja e kufizuar dhe mungesa e trajnimit të duhur të administratorëve, ka qenë shqetësuese sipas ligjit të vjetër. Për më tepër, statusi i administratorëve në përputhje me ligjin e vjetër, për sa i përket pagesës, afatit të emërimit, monitorimit, formimit të duhur, rolit me palët në procesin e falimentimit etj., kishte krijuar konfuzion për vetë administratorët dhe palët. Prandaj, statusi dhe veçanërisht procedurat e pagesave të administratorëve u konsideruan si një dobësi e ligjit të vjetër^[8].

LF-ja është përpjekur të adresojë shumicën e çështjeve, të vendosë rregulla të qarta të emërimit, që parashikojnë administratorët e përkohshëm dhe të përhershëm, mekanizmat mbikqyrës nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit, etj. Për më tepër, më shumë rëndësi ka që përmes ligjeve të nevojshme, tashmë të drejtat dhe detyrat e Administratorëve janë qartësuar, Administratorët duhet të respektojnë (i) një Kod të Etikës për Administratorët e Falimentimit”, (ii) “Standardet Kombëtare për Administrimin e Pasurive të Falimentimit” dhe (iii) të përfitojnë nga të drejta të caktuara të mbrojtjes lidhur me shpërblimin duke marrë parasysh që tani “Kriteret për përcaktimin e shpërblimit të administratorit të përkohshëm të falimentimit, rregullat për shpërblimin e administratorit të falimentimit, si dhe kriteret dhe llogaritja e shpërblimit të kujdestarit” janë miratuar me Vendim të Këshillit

[7] Neni 18.4 i Ligjit nr. 8901/2002 “Për Falimentimin” (shfuqizohet).

[8] Neni 209.2 i LF-së përcakton që me hyrjen e tij në fuqi, neni 104 i ligjit të procedurave tatimore duhet të shfuqizohet duke hequr kështu të drejtën dhe/ose detyrimin e administratës tatimore për të kërkuar hapjen e procedurave. Kjo nënkupton që autoritetet tatimore tani duhet të ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura si kreditorët e tjerë. Kjo ndërhyrje ligjore tani shmang për shembull përfshirjen në procedurat e falimentimit të ndërmarrjeve të reja që nuk mund të marrin fitime në vitet e para të veprimtarisë tregtare

të Ministrave. Në lidhje me trajtimin e administratorit, LF-ja prezantoi si risi ndarjen e shpërblimit të administratorit në dy pjesë: e drejta për një pagë mujore dhe e drejta e shpërblimit si përqindje e numrit të detyrimeve të paguara nga masa e falimentimit dhe rimbursimi për shpenzimet e kryera gjatë kryerjes së detyrës.

Mundësitë për ristrukturimin e borxhit

Sistemi i krijuar sipas ligjit të vjetër kishte tendencë të favorizonte likuidimin në dëm të riorganizimit. Siç kanë treguar statistikave, palët dhe rrjedhimisht gjykatat pothuajse gjithmonë e adresonin procesin drejt likuidimeve, i cili nuk ishte qëllimi kryesor i ligjit të vjetër.

Për më tepër, ligji i vjetër nuk përmbante rregulloret e duhura lidhur me ristrukturimin e borxhit. Përveç ndarjes së qartë të procedurave të riorganizimit dhe likuidimit, LF-ja prezantoi mekanizma të reja që synojnë të rrisin mundësitë e shpëtimit të bizneseve në gjendje të vështirë duke prezantuar mënyra të reja për riorganizimin dhe ristrukturimin e borxheve të debitorit. Një nga tiparet kryesore të LF-së është prezantimi i një procesi të riorganizimit të përshpejtuar. Në përputhje me rrethanat, debitori dhe kreditorët mund të arrijnë një marrëveshje jashtë gjykatës e cila më pas duhet të miratohet nga gjykata e falimentimit. Kjo procedurë e shpejtë e riorganizimit mendohet se do të lehtësojë punën e gjykatës si dhe të pakësojë kostot e bashkëngjitura në procedurat e falimentimit, duke çuar përfundimisht në ruajtjen e vlerës së biznesit.

Mekanizmat e mbikqyrjes

Sipas ligjit të vjetër Agjencia Kombëtare e Falimentimit (“AKF”) u ngarkua me mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave të falimentimit, gjë që çoi në konfuzion të vazhdueshëm në interpretimin e kësaj dispozite.^[9]

Kjo u eliminua në LF-në, duke marrë parasysh që roli i agjencive të falimentimit në praktikat më të mira ndërkombëtare nuk është të marrin pjesë në procedurat specifike të falimentimit, por të organizojnë dhe të administrojnë profesionin e administratorëve të falimentimit, duke dhënë liçenca, duke i revokuar ato, duke ekzaminuar, etj. Kjo është arsyeja pse LF-ja prezantoi funksione të zgjeruara në AKF për sa i përket mbikqyrjes dhe rregullimit të profesionit të administratorit të falimentimit, duke eliminuar rolin konfuz që ligji i vjetër i dha AKF-së në raste specifike. LF-ja zgjeroi rrethin e subjekteve që kanë të drejtë të informohen lidhur me procedurat e falimentimit përtej AKF-së, Gjykatës së Falimentimit, administratorëve ose kujdestarit (palët e interesuara të përcaktuara në ligjin e vjetër).

Për shembull, QKB duhet të marrë informacion në lidhje me fillimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurave të falimentimit, ndërsa Prokurori ka të drejtë të verifikojë dokumentet, vendimet gjyqësore, planin e riorganizimit, ristrukturimin e borxhit etj. në mënyrë që të shmangen abuzimet ose mashtrimet gjatë procedurave të falimentimit. LF-ja parashikon që me marrjen e një kopjeje të vendimit për hapjen e procedurave të

[9] Nënpara d) deri tek Neni 282/3 i ligjit nr. 8901/2002 “Për falimentimin” (i shfuqizuar)

falimentimit, prokurori, për të shmangur abuzimin ose mashtrimin gjatë procedurave të falimentimit, verifikon transferimet dhe veprimet ligjore lidhur me pasuritë e debitorit”.

Duke iu rikthyer AKF-së, LF-ja e përcaktoi atë si autoritetin shtetëror kompetent të cilit i besohet mbikqyrja, trajnimi dhe liçencimi i administratorëve. Agjencia monitoron zbatimin e ligjeve dhe procedurave të falimentimit nga administratorët. Një rol më fuqizues i'u dha AKF-së lidhur me autoritetin për të mbikqyrur çështjet e abuzimit dhe mashtrimin gjatë falimentimit. AKF-ja ka të drejtë të kërkojë raporte nga administratorët e falimentimit, si dhe dokumente, të dhëna dhe procesverbale të mbajtura nga administratorët e falimentimit gjatë procedurave gjyqësore.

Falimentimi ndërkombëtar

LF-ja ka transpozuar ligjin model UNCITRAL për falimentimin ndërkombëtar dhe si rrjedhojë sjell risi në lidhje me riorganizimin për njohjen e një procedure të huaj falimentimi në Shqipëri, duke e harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe me shumicën e legjislacioneve Evropiane. Tani, një përfaqësues i huaj duhet të depozitojë një kërkesë në Gjykatën e Falimentimit në përputhje me nenin 11 të LF-së. Si pasojë, procedurat e falimentimit do të administrohen nga Gjykata e Falimentimit, ku debitori ka qendrën kryesore të interesit. Në parim, qendra kryesore e interesit është vendi ku debitori kryen administrimin e interesave të tij rregullisht në mënyrë të përditshme. Në rast të një shoqërie ose personi juridik, vendi i selisë supozohet të jetë qendra kryesore e interesit, përveç nëse vërtetohet ndryshe. Në bazë të dispozitës së sipërpërmendur, shoqëritë e themeluara sipas juridiksioneve të tjera mund të paraqesin një kërkesë falimentimi në Shqipëri vetëm nëse qendra kryesore e interesit të debitorit është në Shqipëri. Megjithatë, deri sot, asnjë kërkesë nuk u depozitua në gjykatat shqiptare për njohjen e një procedure kryesore të falimentimit të huaj.

Mbyllja e procedurave të falimentimit kur pasuritë e debitorit janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot

Ligji i vjetër i falimentimit parashikonte mbylljen ose mos fillimin e procedurave të falimentimit dhe çregjistrimin e debitorit që nuk kishte mjete të mjaftueshme për të mbuluar kostot e procedurave të falimentimit. Kjo marrëveshje krijoi mundësi të mëdha për skemat e mashtrimit nëpërmjet falimentimit. Procedurat e falimentimit nuk u kryen në praktikë, pasi në shumicën e rasteve, shoqëritë në falimentim nuk kishin më asnjë pasuri, as për kostot e procesit, pavarësisht nga shuma.^[10]

Siç do të shihet më tej në këtë Komentar, me synimin për të siguruar një efikasitet më të lartë të procedurave të falimentimit, LF-ja përdori një proces efektiv të likuidimit. Në të njëjtën kohë dhe për të trajtuar abuzimet e debitorëve të hasura sipas ligjit të vjetër, neni 20 i LF-së parashikon një mekanizëm që mbron kreditorët. Në thelb, neni 20 parashikon që gjykata e falimentimit mund të vendosë të mbyllë procedurën kur pasuritë e debitorit

[10] Nuk ka statistika në dispozicion për numrin e çështjeve të mbyllura nga gjyqtari për shkak të mungesës së mjeteve të mjaftueshme për të mbuluar kostot e falimentimit, por sipas përvojës së autorit ka pasur raste në të kaluarën të mbyllura pikërisht për shkak të arsyes së përmendur.

janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e procedurës së falimentimit, duke i dhënë kreditorëve mundësinë për të kundërshtuar, një mundësi që mungonte në legjislacionin e mëparshëm. Në këtë rast, Gjykata e Falimentimit, informon prokurorin dhe pezullon procedurën për 6 muaj për të mundësuar hetimin nga prokurori.

Ky trajtim i ri dhe i shpejtë i çështjeve ku mungojnë pasuritë jo vetëm që iu ofron kreditorëve një mbrojtje të mëtijshme duke shmangur fshehjen e pasurisë së falimentimit, por do t'u japë edhe gjyqtarëve kohë dhe mundësi të përqendrohen në çështje më të ndërlikuara. Si përfundim, kjo duhet të kontribuojë në rritjen e efektivitetit në kornizën e paaftësisë paguese.

III. DUKE MENDUAR PËR PROCEDURAT E FALIMENTIMIT

III.I. Çfarë veprimesh mund të kryejë një person për të shmangur procedurat e falimentimit?

Procedurat e falimentimit nuk janë mënyra e preferuar për të dalë nga borxhet. Përkundrazi, ato shpesh janë alternativa e fundit pasi të gjitha opsionet e tjera qenë pa rezultat. Në shumë raste debitorët do të jenë në gjendje të shmangin procedurat formale të falimentimit edhe nëse janë të paaftë për të paguar, nëse arrijnë një marrëveshje me kreditorët e tyre. Edhe nëse përpjekja në mirëbesim për ristrukturim privat dështon, procedurat e falimentimit shpesh kanë më shumë gjasa të jenë të suksesshme nëse fillohen pas përpjekjeve të tilla. Për më tepër, një gjykatë kompetente ka më shumë gjasa të mbështesë debitorin në rrugën e tij të gjatë dhe me pengesa gjatë procedurave. Si rrjedhojë, debitorët këshillohen të ndërmarrin të gjitha hapat sa më shpejt që të jetë e mundur për të shmangur falimentimin. Kjo jo vetëm që mund të shpëtojë debitorët nga falimentimi në shumë raste, por mund të funksionojë në avantazhin e tyre gjatë procedurave kur falimentimi është i pashmangshëm.

Shembull: *CarCare Shpk ofron shërbime për mirëmbajtjen e automjeteve. Gjatë 24 muajve të fundit fitimet e biznesit ishin tepër të mëdha. Gjatë muajve të fundit shoqëria u përball me ulje të kërkesës dhe kishte vështirësi në pagimin e borxheve ndaj furnizuesve të materialeve. CarCare në përpjekje për të shmangur falimentimin e pritshëm, kërkoi një mbledhje me të gjithë kreditorët e saj. Ajo ofroi shlyerjen e borxhit për të gjithë kreditorët 4 muaj me vonë të të gjitha pagesave në këmbim të një norme shtesë interesi prej 6% të vendosur për shkak të vonesës, si dhe kushteve dhe zgjidhjeve të tjera ligjore të përshtatshme për të siguruar qëndrueshmërinë e shoqërisë sipas propozimit të ri, si dhe gjasat për të qenë në gjendje të plotësojë kushtet e reja në vazhdimësi.*

Rezultati: *Kreditorët mund të pranojnë ose refuzojnë propozimin. Megjithatë, kjo tregon një propozim në mirëbesim nga CarCare. Në rast se propozimi refuzohet dhe si përfundim nisim procedurat e falimentimit, përpjekjet e ndershme të CarCare për të shmangur falimentimin do të luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e pranimit të një plani riorganizimi si pjesë e procedurave të falimentimit.*

Strategji të tjera shtesë për të ndihmuar në shmangien e falimentimit, përshkruhen më poshtë.

- Shlyerja e borxheve me kreditorët dhe me përmbaruesit

Shpesh, thjesht qasja ndaj një kreditori në mënyrë të drejtpërdrejtë mund ta ndihmojë një person për të shmangur procedurat e falimentimit. Debitorët të cilët nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre, mund ta shohin si mundësi gjetjen e një lloji plani alternativ shlyerjeje me kreditorët e tyre. Kjo mund të përfshijë për shembull

riprogramimin e pagesave ose uljen e interesave. Edhe nëse propozimi i një debitori refuzohet, përsëri ai mund të tregojë besimin e tij të mirë.

Kur shuma e borxhit është e madhe ose në të përfshihen një numër i madh kreditorësh, propozimi i debitorit për një mbledhje të kreditorëve dhe një përpjekje për të rinegociuar marrëveshjet e kredisë mund të funksionojë. Kreditorët mund të marrin parasysh situatën e përgjithshme dhe të përpiqen të shmangin procedurat formale të falimentimit duke kuptuar që me kompromis mund të shmangnin një situatë të dëmshme për të gjithë ata. Si rrjedhim, ata mund të bien dakord për zvogëlimin e detyrimit të papaguar me objektivin që më në fund të arrijnë një rezultat më të mirë.

- Ulja e shpenzimeve

Ulja e shpenzimeve ndryshon midis debitorëve persona fizikë dhe personave juridikë. Personat fizikë mund të ndalojnë së përdoruri kartat e kreditit duke zvogëluar kështu akumulimin e borxhit. Më tej, ata mund të vendosin t'i shtyjnë disa blerje, të paktën përkohësisht. Personat juridikë mund të zgjedhin t'i ulin shpenzimet duke zvogëluar numrin e stafit ose pagat e tyre ose përmes uljes së shpenzimeve të biznesit, duke përfshirë ndalimin e çdo aktiviteti që nuk është produktiv.

- Rritja e të ardhurave

Debitorët që arrijnë të rrisin të ardhurat kanë shanse më të mira për të shmangur falimentimin. Kreditorët mund ta shohin këtë si një arsye kryesore për të mbështetur përpjekjet e debitorëve. Të ardhurat e një personi fizik mund të rriten nga punësimi shtesë ose nga shitja e shërbimeve. Në disa situata, debitorët mund të gjenerojnë të ardhura nga investimi edhe pse rreziku i dështimit gjithashtu duhet patur parasysh. Personat juridikë mund të jenë të suksesshëm në rritjen e të ardhurave duke ripërcaktuar pasuritë në aktivitete më fitimprurëse ose përmes rritjes së shitjeve.

- “Mos ecni në litarin e ngushtë të borxhit”

Debitorët shpesh këshillohen të dalin nga falimentimi (dhe nëse është e mundur, nga borxhet) dhe të qëndrojnë në atë situatë.

Shpesh njerëzit e shikojnë jetesën me borxhe si diçka normale. Rreziku endemik për këto situata nuk është gjithmonë i dukshëm deri në shfaqjet e paaftësisë paguese, të cilat janë shpesh të papritura. Komoditeti i të jetuarit me borxhe mund të përkeqësohet nën një peshë të padurueshme. Mund të ndikojë gjithashtu në aftësinë e tij për të marrë borxh, duke zvogëluar më tej mundësinë e këtij personi për të patur akses në financim dhe duke e shtyrë gradualisht personin në pikën që nuk ka më kthim pas.

- Ndihma profesionale

Debitorët mund të kërkojnë ndihmë profesionale. Kur debitorët nuk janë në gjendje të gjejnë vetë zgjidhje, mund të garantohen disa mënyra të tjera. Kreditorët ndonjëherë humbasin besimin në synimet ose aftësinë e debitorëve të tyre për të përmbushur detyrimet dhe refuzojnë të komunikojnë me ta. Në këtë pikë, mund të jetë e nevojshme përfshirja e një pale të tretë. Në shumë vende, programet e administrimit të borxhit ose ndihma profesionale janë një ndihmë e çmuar për t'u marrë me paaftësinë paguese. Në Shqipëri, kjo industri nuk është plotësisht e zhvilluar, megjithatë disa subjekte të tilla si zyra ligjore, kontabilistë dhe zyra kontabël kanë aftësinë të

ndihmojnë në këtë kontekst. Kjo mund t'i ndihmojë debitorët të zbulojnë mënyra të reja për të organizuar borxhet e tyre. Gjithashtu mund t'i ndihmojë debitorët të shmangin kontaktin e drejtpërdrejtë me agjencitë e mbledhjes së parave dhe në vend të kësaj të përqendrohen në të mësuarit se si të trajtojnë problemet e borxhit duke përvetësuar mënyra ose praktika të reja.

III.II. Duke menduar për procedurën e falimentimit: një përmbledhje e shkurtër se si të veprohet

Debitori duhet të ndjekë 6 rregulla kryesore kur konsideron procedurat zyrtare të falimentimit:

1. Kostoja e Procedurave të Falimentimit

Para zgjedhjes së opsionit të paraqitjes së një kërkesë zyrtare, debitorët duhet të vlerësojnë nëse mund të mbulojnë koston e procedurave të falimentimit. Kushti paraprak i gjykatës për miratimin e kërkesës për falimentim është që të sigurohet që kostoja e procedurave mbulohet nga debitori. Në të kundër, gjykata do ta bllokojë dhe refuzojë kërkesën.

Nga ana praktike,^[11] gjykata e falimentimit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një eksperti ose një administratori të përkohshëm, vlerëson nëse pasuritë e debitorit mbulojnë koston e procedurave të falimentimit. Kjo është një provë thelbësore se si pasuritë në masën e falimentimit duhet të paktën të mbulojnë shpenzimet e procedurave të falimentimit. Përndryshe, gjykata duhet t'i ndërpresë këto të fundit.^[12]

Megjithatë, para marrjes së një vendimi të tillë potencialisht të rëndësishëm, gjykata duhet të informojë kreditorët dhe të bëjë një njoftim publik në QKB dhe autoritetet e tjera publike. Brenda 60 ditëve nga ky njoftim, një kreditor, ose një palë e interesuar, ka mundësinë që të kundërshtojë një ndërprerje të tillë. Një kundërshtim i tillë mund të bazohet në arsyet e mëposhtme:

- i. Debitori ka pasuri;
- ii. Është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm për transaksionet e debitorit që mund të çojnë në shmangien e tyre.

Sidoqoftë, sipas nenit 20.2 të LF-së, gjykata e falimentimit nuk mund të ndërpresë procedurën nëse kreditorët ose palët e tjera të interesuara nuk informohen dhe një njoftim publik i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe autoriteteve të tjera publike. Ky njoftim publik në lidhje me situatën e debitorit synon të lejojë çdo palë të interesuar të kundërshtojë ndërprerjen në rast se është në dijeni për ekzistencën e pasurive [të pazbuluara] që i përkasin debitorit ose në rast se hetimi i mëtejshëm është i nevojshëm për veprime të caktuara të ndërmarra nga debitori në lidhje me pasuritë e saj kur veprime të tilla ishin të dëmshme për pasurinë e falimentimit.

[11] Nëse një debitor nuk ka pasuri, LF-ja zgjedh ruajtjen e burimeve institucionale dhe mbylljen e çështjes. Ky është një opsion i arsyeshëm pasi procedurat e falimentimit mund të mos përmirësojnë rikuperimin e kreditorit në këto rrethana.

[12] Shikoni Nenin 20 të LF-së

Shembull: *Supozoni sikur Albania Agri Shpk (AA) është e paaftë të paguajë dhe merr në konsideratë procedurat e falimentimit. Supozoni se pasuritë e shoqërisë, përfshirë llogarinë e saj bankare, kanë vlerë më të vogël se pretendimet e të gjithë kreditorëve të AA-së, por më të madhe se kostoja e pritshme e procedurave të falimentimit.*

Rezultati: *Për shkak se pasuritë e AA-së janë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e falimentimit, kërkesa e AA-së ka gjasa të pranohet. Do të jetë i njëjti rast edhe nëse kostot do të ulin më tej vlerën e masës së falimentimit.*

Në këto lloj rastesh, në përputhje me nenin 20.3 të LF-së, gjykata e falimentimit i drejton çështjen zyrës së prokurorit për të vazhduar hetimet e mëtejshme duke pezulluar procedurat e falimentimit për një periudhë prej 6 muajsh në mënyrë që të lejojë prokurorinë të përfundojë hetimin e saj.

2. Merrni parasysh fillimisht Opsionin e Riorganizimit

LF-ja parashikon një mënyrë të vetme për fillimin e procedurave të falimentimit e cila mund të ndahet në likuidim ose riorganizim. Në çdo kohë gjatë procedurave, një debitor mund të kërkojë likuidimin e menjëhershëm. Megjithatë, personat fizikë dhe juridikë që nisin procedurat e falimentimit duhet gjithmonë të marrin parasysh mundësinë e riorganizimit të borxheve me miratimin e kreditorëve të tyre. Kjo mund të përfshijë periudha të zgjatura shlyerjesh, zbritje, norma më të ulëta interesi etj. Nga këndvështrimi i debitorit, kjo zgjidhje zakonisht preferohet në vend të likuidimit pasi debitori mund të vazhdojë të administrojë biznesin e tij.

Shembull: *Alba ka krijuar borxhe nga disa persona që i kanë dhënë hua dhe nuk mund t'i kthejë ato në kohë siç është rënë dakord. Megjithatë, Alba, nuk arriti t'i bindte kreditorët e saj për një shtyrje të afatit të shlyerjes. Gjithsesi, ajo e di se pasuritë e saj kanë një vlerë rishitje prej 45% në total të të gjitha detyrimeve të papaguara. Për më tepër, Alba mund të vërtetojë se nëse kreditorët e saj do të bien dakord të shtyjnë shlyerjen e huasë me gjashtë muaj, ajo do të jetë në gjendje të shlyejë 70% të shumave që duhen paguar në atë kohë.*

Rezultati: *Së pari, Alba duhet të përpiqet të shmangë procedurat e falimentimit duke hyrë më parë në negociata me kreditorët e saj. Kreditorët mund të pranojnë marrëveshje të reja ku do të përfitojnë të gjithë duke shmangur procedurat e falimentimit. Megjithatë, nëse këto negociata dështojnë dhe falimentimi mbetet e vetmja zgjidhje, Alba ka ende mundësi duke e paraqitur çështjen e saj në gjykatën e falimentimit.*

3. Merrni parasysh edhe Opsionin e Likuidimit

Shembull: *Rena Shpk shpalli falimentimin. Ajo negocioi për disa muaj me 2 kreditorët të saj për rishlyerje, por nuk pati rezultat. Pas dështimit të këtyre negociatave, Rena po merr parasysh depozitimin e kërkesës ndërsa bashkëngjit të njëjtin plan si një propozim brenda procedurës së falimentimit.*

Rezultati: *Ka shumë gjasa që kreditorët do të refuzojë propozimin sipas të njëjtave kushte dhe për pasojë ka shumë mundësi që gjykata të urdhërojë likuidimin e Rena Shpk.*

Janë të shumta arsyet që mund t'i shtyjnë kreditorët të përzgjedhin likuidimin e pasurive të debitorit të tyre në vend të riorganizimit të borxheve. Në shumë raste, kjo mund të jetë një zgjidhje e përshtatshme. Si rrjedhojë, debitori duhet ta marrë në konsideratë këtë opsion. Zbulimi, vlera dhe vendndodhja e pasurive ekzistuese është veçanërisht e rëndësishme dhe debitori duhet të pajtohet dhe të bashkëpunojë plotësisht me të gjitha palët.

4. Përgatitni kërkesën dhe Depozitojeni! – Kërkesa

Depozitoni një kërkesë të plotë bashkë me dokumentet përkatëse. Debitorët të cilët vendosin të përfshihen në procedurat e falimentimit, duhet të ndjekin udhëzimet e LF-së dhe të përfshijnë të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme siç parashikohet në Nenin 14 ndërsa kreditorët duhet t'i referohen nenit 16 të LF-së (shikoni seksionin IV më poshtë). Në kërkesën e tyre, debitorët ose kreditorët duhet të jenë të qartë dhe transparentë në lidhje me arsyet e kërkesës dhe të përfshijnë në të, të gjitha informacionet zyrtare në lidhje me veprimtarinë e tyre. Kërkesa duhet të përfshijë gjithashtu informacione të detajuara financiare për tre vitet e fundit, si dhe të gjitha informacionet për pasuritë e debitorit. Më në fund, debitori që paraqet kërkesën duhet të përfshijë informacione për të gjithë kreditorët e tij të njohur.^[13]

5. Mos harroni shkarkimin nga borxhi!

Shpesh, një nga gjërat më të rëndësishme që duhet të mbajnë parasysh debitorët persona fizikë të cilët aplikojnë për procedurat e falimentimit është që të shkarkohen nga borxhet shumëfishimi i procedurave të ekzekutimit. Debitorët persona fizikë mund të paraqesin në çdo kohë gjatë procedurave të falimentimit një kërkesë për shkarkimin nga borxhet e papaguara. Megjithatë, një kërkesë e tillë përfshin në të njëjtën kohë një kërkesë për likuidim.

Shembull: *Adi depoziton një kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit në përputhje me Nenin 14 të LF-së. Kjo kërkesë është e dyta e depozituar nga Adi në 5 vitet e fundit të cilit i ishte dhënë tashmë një shkarkim nga borxhi.*

Rezultati: *Një shkarkim i dytë nga borxhi mund t'i jepet Adi-t. Sidoqoftë, nëse shkarkimi i parë është anuluar për arsye të mosrespektimit, gjykata e falimentimit nuk do të miratojë kërkesën e dytë të shkarkimit nga borxhi.*

Shkarkimi nga borxhi mund të refuzohet nëse një debitor nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në Nenin 158 të ligjit që përfshin dy pika: dëshminë e pastër të penalitetit dhe regjistrimin e transaksioneve të zhvilluara në mirëbesim.

6. Bashkëpunoni plotësisht gjatë Procedurës së Falimentimit

Shembull: *ADA Shpk, një firmë që i nënshtrohet riorganizimit, ka dy kreditorë. Ajo është e interesuar të paguajë një borxh që ka ndaj kreditorit kryesor të saj, Bankës Teta sepse ky borxh mbledh norma interesi më të larta se borxhi ndaj Bankës Gama.*

[13] Shënim: Neni 14 parashikon kërkesa shtesë për pajtueshmërinë. Lexojini dhe mësoni se si të veproni plotësisht në përputhje me të. Sigurisht, këshillat specifike ligjore rekomandohen për të siguruar që pasojat e procesit të kuptohen mirë në rastet konkrete.

Rezultati: *Ky transaksion i pazakontë duhet të kontrollohet fillimisht nga administratori. Administratori mund të autorizojë transaksionin nëse ai rrit vlerën e masës së falimentimit dhe nëse nuk ndikon negativisht në pozicionin e Bankës Gama ose të kreditorëve të tjerë të tij.*

LF-ja përfshin kërkesa të rrepta që duhen përmbushur nga debitorët. Këto kërkesa mund të jenë në lidhje me pjesëmarrës të ndryshëm në procedurë, përfshirë; gjykatën, administratorin dhe kreditorët. Për shembull, debitorët e falimentimit duhet të mbajnë një marrëdhënie të mirë pune me administratorët dhe t'i përditësojnë për vendimet që mund të ndikojnë të drejtat ose pozicionet e kreditorëve.

IV. DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR SHPALLJEN E FALIMENTIMIT

Debitori ose kreditorët e tij mund të depozitojnë një kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit duke ndjekur kërkesat e përcaktuara në ligj.^[14] Kur një debitor depoziton kërkesën për falimentim, kërkesa e tij mund të bazohet në paaftësi paguese aktuale ose në pritjen që paaftësia paguese do të lindë në të ardhmen e afërt - e cila është diçka që LF-ja jo vetëm e lejon, por gjithashtu e inkurajon.^[15] Kur depozitoni në raste të paaftësisë paguese të “parashikueshme”, dhe kështu luftoni vështirësitë financiare në kohën e duhur, gjasat e shpëtimit të shoqërisë - dhe sigurimit të nivelit më të lartë të kthimit ndaj kreditorëve - shpesh janë shumë më të larta. LF-ja është më kufizuese në rast të procedurave të falimentimit të kërkuara nga kreditori. Nënndarjet e mëposhtme përshkruajnë mekanizmat për fillimin e falimentimit, si nga kreditorët ashtu edhe nga debitorët.

IV.I. Kërkësa për fillimin e procedurave të falimentimit nga kreditorët.

Paaftësia paguese është një dukuri e zakonshme. Si e tillë, palët kontraktuese janë të vetëdijshme që ekziston mundësia që çdo debitor të bëhet i paaftë për të paguar. Për më tepër, pasi një debitor bëhet i paaftë për të paguar, ai duhet ta trajtojë problemin në një mënyrë të arsyeshme dhe efikase. Si i tillë, sistemet efektive të falimentimit i'u sjell përfitime kreditorëve në disa mënyra, përfshirë:

- Rrit mundësinë e rikuperimit për kreditorin. Ekzistojnë disa mënyra për të ndodhur kjo, duke përfshirë fillimin e hershëm të procedurave të falimentimit, shmangien e dyfishimit të kostove dhe përmirësimin e koordinimit midis kreditorëve.
- Rrit besimin midis palëve, duke rritur kështu mundësinë e riorganizimeve të suksesshme. Kur një debitor bëhet i paaftë për të paguar, kreditorët shqetësohen për menaxhimin e situatës, duke krijuar kështu një mjedis jo të favorshëm për marrëveshje. Procedurat efektive të falimentimit prezantojnë aktorët e paanshëm në marrëdhënien shumë-palëshe dhe i'u japin kreditorëve informacionin e nevojshëm për të marrë vendime të bazuara në lidhje me rastin.
- Për shkak se një ligj i efektshëm i falimentimit ka si qëllim të rrisë rikuperimin e kreditorit pas falimentimit, grupi i pasurive të disponueshme që kreditorët duhet të japin hua është zgjeruar. Kështu, kreditorët mund të përfitojnë nga më shumë mundësi.
- Siguron kushte të favorshme për financimin pas fillimit të procedurave të falimentimit, duke i'u ofruar kreditorëve mundësi shtesë biznesi në tregun e huave me vështirësi financiare.
- Mbron kreditorët tregtarë duke siguruar rikuperim të shpejtë dhe efikas. Normat e ulëta të rikuperimit mund të ndikojnë posaçërisht dhe negativisht kreditorët

[14] Shikoni Nenin 13 të LF-së.

[15] Shikoni Nenin 14 të LF-së.

tregtarë. Këta kreditorë kanë tendencë të jenë më të vegjël në përmasa, të përfshijnë më pak masa mbrojtëse kontraktuale kur merren me debitorin dhe të jenë më të prirur për të vuajtur pasoja negative nga mos përmbushja e palës tjetër. Ligjet efektive të falimentimit lejojnë zgjidhjen e shpejtë të çështjeve dhe rikuperim të shpejtë për të gjithë kreditorët e përfshirë, duke zvogëluar efektin negativ të një debitori që nuk përmbush detyrimet.

Forma e Kërkesës

Për të kërkuar fillimin e një procedure falimentimi për një debitor, kreditori duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit, ku debitori ka selinë ose vendbanimin e tij.^[16] Në depozitimin e tij, kreditori duhet të dëshmojë përmes dokumentacionit, ekzistencën e pretendimit dhe se pretendimi përkatës është likuid, i maturuar dhe i papaguar. Dokumentet bashkangjitur kërkesës do të përbëjnë një pjesë të pandarë të kërkesës së kreditorit në gjykatën e falimentimit.^[17]

Detyrimi për të vërtetuar gjendjen e paaftësisë paguese të Debitorit

Kërkësat për falimentin nga kreditorët janë më kufizues sesa ai i kërkuar nga debitori. Procedurat do të hapen me kërkesën e një kreditori vetëm nëse kreditori vërteton gjendjen e paaftësisë paguese të debitorit.^[18] LF-ja e përkufizon "paaftësinë paguese" si "*situatën kur një debitor, qoftë person fizik ose juridik, nuk është në gjendje të paguajë borxhet e tij brenda afatit. Për personat juridikë, paaftësia paguese i referohet gjithashtu situatës financiare, ku shuma e detyrimeve të debitorit tejkalon vlerën e përgjithshme të pasurive të tij*". Gjykata do të rishikojë kërkesën e kreditorit dhe nëse është në përputhje me kërkesat ligjore, do ta njoftojë debitorin për kërkesën brenda 5 ditësh.^[19]

Ndërsa një kreditor mund të vërtetojë paaftësinë paguese të një debitori me mjete të tjera, LF-ja përfshin një prezumim të kundërshtueshëm të paaftësisë paguese për ato raste kur kreditori nuk ka qenë në gjendje të ekzekutojë një detyrim në një procedurë të detyrueshme ekzekutimi.^[20] Në të vërtetë, nëse një kreditor ka një titull ekzekutiv për një detyrim monetar dhe procedurat e ekzekutimit kanë filluar pas lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit

[16] Shikoni nenin 11 të LF-së.

[17] Kërkesa zakonisht përmban informacionin e mëposhtëm:

- Emrin e gjykatës në të cilën depozitohet kërkesa;
- Informacionin e identifikimit për kreditorin [emri i shoqërisë ose emri dhe adresa e kreditorit];
- Shumën e pretenduar, faktet dhe arsyet për shumën e pretenduar, përfshirë provën se pretendimi është likuid, i maturuar dhe i papaguar;
- Faktet dhe provat mbi statusin e paaftësisë paguese të debitorit;
- Listën e dokumenteve që mbështesin informacionin në pikën (iii) dhe (iv) më sipër, i cili do t'i bashkëngjitet kërkesës.

[18] Shikoni nenin 16 të LF-së.

[19] Shikoni nenin 18 të LF-së.

[20] Shikoni nenin 16 të LF-së dhe nenin 517 të Kodit të Procedurës Civile.

nga gjykata përkatëse, gjendja e paaftësisë paguese të debitorit do të prezumohet, pas kalimit të afateve, d.m.th. prej pesë ditësh kur objekti i vendimit të gjykatës përfshin një pagë ose urdhër për detyrimin për ushqim dhe një afat kohor prej 10 ditësh për të gjitha rastet e tjera.^[21]

Debitori mund të kundërshtojë kërkesën e kreditorit duke paraqitur një kundërshtim brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Kjo zgjat vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit, pasi gjykata e falimentimit duhet t'i vlerësojë të dy pozicionet. Nëse nuk paraqiten kundërshtime brenda afatit dhe kërkesat zyrtare të kërkesës përmbushen, gjykata e falimentimit merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit.

Veprimet e ndërmarra nga Gjykata pas kundërshtimit të debitorit

Nëse kërkesa e kreditorit është kundërshtuar nga debitori, gjykata e falimentimit duhet të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:^[22]

- i. të caktojë datën e seancës gjyqësore;
- ii. të thërrasë debitorin dhe kreditorin për të marrë pjesë në seancën gjyqësore;
- iii. mund të emërojë një ekspert^[23] ose një administrator të përkohshëm^[24] për të dhënë një mendim për fillimin e procedurave të falimentimit nëse ndonjë nga palët e kërkon ose gjykata e falimentimit e konsideron të domosdoshme.^[25] Mendimi i kërkuar mund të shërbejë për të:
 - verifikuar nëse ka arsye që justifikojnë fillimin e procedurave të falimentimit;
 - verifikuar nëse pronat e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurave të falimentimit;
 - dhënë një mendim nëse është e nevojshme të vendosen masa të përkohshme^[26] për mbrojtjen e pasurive.

[21] Për të provuar këtë, kreditori mund t'i sigurojë gjykatës njoftimin për përmbartimin vullnetar që i është dorëzuar debitorit nga përmbartuesi gjyqësor.

[22] Shikoni Nenin 19 të LF-së.

[23] LF-ja e përkufizon "ekspertin" si "një profesionist të kualifikuar me njohuri specifike, të zhvilluara në një fushë të caktuar, të pavarur nga palët dhe të regjistruar në regjistrin e ekspertëve të mbajtur nga gjykata e falimentimit. Në rastet kur fusha e ekspertizës nuk mbulohet nga regjistri i ekspertëve i mbajtur nga gjykata e falimentimit, "Ekspert" do të nënkuptohet një profesionist i kualifikuar me njohuri specifike në një fushë të caktuar i cili jep mendimin e tij / saj të pavarur në një proces gjyqësor në atë fushë të specializuar."

[24] LF-ja e përkufizon "administratorin e përkohshëm" një "administrator, të emëruar nga gjykata e falimentimit para fillimit të procedurave të falimentimit, i cili kryen funksionin e mbikqyrjes ose të administratorit të falimentimit, në përputhje me Nenin 23 të LF-së".

[25] Një administrator i përkohshëm mund të thirret gjithashtu për të mbikqyrur aktivitetet e debitorit

[26] LF-ja i përkufizon "masat e përkohshme" si "masa parandaluese të miratuara nga Gjykata e Falimentimit për të shmangur përkeqësimin e masës së falimentimit, sipas kushteve të parashikuara në Nenin 22 të Ligjit për Falimentimin".

Mundësia për të lëshuar Masa të Përkohshme “Mbrotjëse”

Periodha nga depozitimi i kërkesës deri në vendimin e gjykatës për fillimin e procedurave të falimentimit është kalimtare ku mbrojtjet që rrjedhin nga procedurat e falimentimit nuk kanë filluar akoma. Si rezultat, mund të jetë nevoja për të prezantuar masa të përkohshme^[27] për të parandaluar përkeqësimin e masës së falimentimit.^[28]

LF-ja i'u jep kreditorëve të drejtën të kërkojnë që gjykata e falimentimit të vendosë masa të veçanta mbi pasurinë e debitorit për të shmangur dëmtimin e masës së falimentimit.^[29] Masat e përkohshme mund të vendosen gjithashtu nga gjykata e falimentimit *ex officio*. Në çdo rast, masat e përkohshme mund të vendosen vetëm brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës së falimentimit dhe para se të vendoset fillimi i procedurave të falimentimit.

Mund të vendosen lloje të ndryshme të masave mbrotjëse, përfshirë:

- i. emërimin e një administratori të përkohshëm për të mbikqyrur debitorin ose për të zëvendësuar debitorin në administrim;
- ii. vendosjen e një ndalimi të së drejtës së debitorit për të disponuar pasurinë në çdo mënyrë që nuk është në rrjedhën normale të veprimtarisë së biznesit;
- iii. urdhrin për masa të tjera të nevojshme për të shmangur përkeqësimin e situatës ekonomike / financiare të debitorit në dëm të kreditorëve.

Për shkak të natyrës së tyre të përkohshme, këto masa mund të vendosen vetëm për 30 ditë, megjithëse mund të kërkojë një zgjatje për 30 ditë shtesë. Pas përfundimit të afatit të lartpërmendur, masat e përkohshme mbi pasuritë e debitorit humbasin efektet e tyre.

Ndërsa shtrirja e tyre e përkohshme siguron disa masa mbrotjëse, gjykatat gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshme për ndikimet që këto masa mund të kenë te kreditorët e siguruar, pasi këta kreditorë kanë negociuar për mbrotjtje të veçantë. Në të vërtetë, në masën që një masë e përkohshme mund të ndikojë në të drejtën e kreditorëve të siguruar për të ekzekutuar kolateralin e tij, një gjykatë mund ta vendosë atë vetëm me kusht që vlera e kolateralit të jetë më e lartë se vlera e huasë dhe që gjykata të organizojë një seancë gjyqësore me të gjithë kreditorët e siguruar të prekur.

Vendimi i gjykatës për emërimin e një administratori të përkohshëm ose vendosjen e kufizimeve për disponimin e pasurisë publikohet në QKB dhe/ose në institucionet e tjera.^[30] I njëjti njoftim bëhet pas shfuqizimit të tyre.^[31]

Masat e përkohshme janë nga natyra konservatore dhe mund të përdoren në dobi të kreditorëve në kohën kur debitorët mund të jenë të gatshëm të përfshihen në transaksione më të rrezikshme biznesi ose madje mund të tundojnë të fshehin pasuritë. Sidoqoftë, nëse nuk janë përshtatur siç duhet, këto masa mund të dëmtojnë gjithashtu në mënyrë të panevojshme kreditorët ose ushtrimin e aktivitetit të debitorit. Duke njohur këtë mundësi,

[27] Shikoni Nenin 22 të LF-së.

[28] Me masë falimentimi nënkuptohet "tërësia e pasurive dhe të drejtave të debitorit në datën e fillimit të procedurës së falimentimit, si dhe pasuritë dhe të drejtat e fituara gjatë një procedure të tillë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, përveç pasurive që përjashtohen nga ekzekutimi i detyrueshëm siç parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile". Shikoni Nenin 3 të LF-së.

[29] Shikoni Nenin 22 të LF-së.

[30] Shikoni Nenin 24 të LF-së.

[31] Shikoni Nenin 26 të LF-së.

LF-ja i lejon gjithashtu çdo pale të prekur nga një masë e përkohshme e vendosur ose që është refuzuar të vendoset nga gjykata e falimentimit, përfshirë kreditorët, të drejtën e ankimit.

Emërimi i Administratorit të Përkohshëm

Siç u diskutua më sipër, emërimi i një administratori të përkohshëm është ndër masat e mundshme të përkohshme. Gjykata e falimentimit mund ta ngarkojë këtë administrator të mbikqyrë debitorin ose të administrojë drejtpërdrejt punët e tij.^[32] Ky i fundit referohet si një administrator i përkohshëm falimentimi, ndërsa tjetri është një administrator i përkohshëm mbikqyrjeje. Pas emërimit, administratori i përkohshëm i falimentimit do të ngarkohet me sigurimin dhe ruajtjen e pasurive të debitorit, si dhe me administrimin e punëve të përditshme të debitorit. Me emërimin e një administratori të përkohshëm të falimentimit, e drejta për të disponuar pasuritë e veta zakonisht i hiqet debitorit.

Për shkak se emërimi i tij vjen para hapjes së çështjes së falimentimit, administratori i përkohshëm i falimentimit duhet të përpiqet të mbajë një vazhdim normal të veprimtarisë tregtare të një debitorit, pasi kjo mund të parandalojë humbjet e panevojshme dhe të lehtësojë rezultatet e vazhdimin të operimit nëse hapet procedura e falimentimit.^[33] Në këtë aspekt, një administrator i përkohshëm falimentimi i cili identifikon dhënien e disa ndihmave, shërbimeve ose kredisë si të nevojshme për vazhdimin e aktivitetit mund të përcaktojë pagesa me përparësi specifike për ofruesit e këtyre ndihmave. Duke vepruar kështu, administratori i përkohshëm i falimentimit mund t'i konsiderojë ata si kreditorë të procedurës së falimentimit.^[34] Megjithatë, për të bërë pagesa me përparësi, administratori i përkohshëm i falimentimit do të kërkojë miratimin paraprak të gjykatës. Gjykata, nga ana tjetër, do të japë një miratim të tillë nëse të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen: a) kryerja e pagesave të tilla me përparësi është e nevojshme për vazhdimin e veprimtarive të debitorit, b) furnizimi i këtyre mallrave konsiderohet thelbësor, dhe c) është në interesin më të mirë të kreditorëve dhe të masës së falimentimit.^[35] Vetëm në raste urgjente administratori i përkohshëm i falimentimit mund t'i kryejë këto pagesa pa miratimin paraprak të gjykatës.

Emërimi i një administratori të përkohshëm të mbikqyrjes, nga ana tjetër, siguron një ndërhyrje më pak të rreptë. Pas emërimit të një administratori të përkohshëm të mbikqyrjes, debitori vazhdon të ushtrojë të drejtën e disponimit të pasurive të tij. Sidoqoftë, e drejta e tij e disponimit vëzhgohet nga administratori i përkohshëm i mbikqyrjes^[36] i cili, pasi informohet për situatat në fjalë, mund t'i kërkojë gjykatës të vendosë masa të tjera.^[37] Për

[32] Shikoni Nenin 23 të LF-së.

[33] Më tej, ndihmon për të mbrojtur debitorin në rastet kur një çështje falimentimi nuk hapet.

[34] Kreditorë të procedurës së falimentimit janë ata, pretendimi i të cilëve është ngritur pas fillimit të procedurës së falimentimit, i cili është përmbushur nga masa e falimentimit në mënyrën dhe me kufizimet e përcaktuara në Nenin 35. Shikoni Nenin 3 të LF-së.

[35] Shikoni Nenin 23 të LF-së.

[36] Për shkak të efekteve të tij të mundshme në masën e falimentimit, administratorët e përkohshëm të mbikqyrjes duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë veprimeve që shkojnë përtej administrimit të përditshëm të veprimtarisë së debitorit.

[37] Shikoni Nenin 23 të LF-së.

shembull, administratori i përkohshëm i mbikqyrjes mund të kërkojë vendosjen e ndalimit të së drejtës së një debitori për të disponuar pasuritë e tij.^[38]

Të dy llojeve të administratorëve të përkohshëm i'u jepen të drejta të përgjithshme kontrolli në mënyrë që të jenë në gjendje të kryejnë misionin e tyre. Kështu, ata kanë të drejtë të hyjnë dhe të kontrollojnë ambientet e debitorit, si dhe të kontrollojnë librat kontabël. Për më tepër, administratorët e përkohshëm përfitojnë nga detyra e debitorit për të vënë në dispozicion të administratorit të përkohshëm çdo informacion tjetër të nevojshëm për kryerjen e detyrave nga ky i fundit.

Marrja e vendimit për kërkesën e kreditorit për fillimin e procedurave të falimentimit

Debitori ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim fillimin e procedurave të falimentimit brenda 10 ditëve nga njoftimi i kërkesës, duke siguruar të gjitha dokumentet e nevojshme për të mbështetur pretendimet e tij. Nëse debitori nuk kundërshton në kohë fillimin e procedurës së falimentimit, falimentimi deklaron fillimin e procedurës. Në këtë mënyrë, pasi palëve u jepet një mundësi për të paraqitur pikëpamjet e tyre, gjykata e falimentimit mund të:

- i. refuzojë kërkesën e kreditorit për fillimin e procedurave të falimentimit për shkak të mungesës së bazës ligjore d.m.th. kreditori nuk arriti të vërtetojë paaftësinë paguese të debitorit ose ekzistencën e një pretendimi likuid, të maturuar dhe të papaguar;
- ii. refuzojë kërkesën e kreditorit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- iii. pranojë kërkesën e kreditorit dhe të marrë vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit

IV.II. Kërkesa për fillimin e procedurës së falimentimit nga debitorët

Siç u parashtrua në Seksionin III të këtij Komentari, Debitorët së pari duhet të përpiqen të shmangin paaftësinë paguese. Sidoqoftë ndonjëherë, edhe përpjekjet më të mira mund të mos mjaftojnë për ta parandaluar atë. Në një rast të tillë, sistemet efektive të falimentimit lejojnë debitorët të marrin frymë me më shumë lehtësi sapo të hyjnë në procedura zyrtare dhe të parandalojnë një garë për pasuritë e tij. Për më tepër, ato rrisin besimin midis palëve, ndërsa kufizojnë gjithashtu probleme të veprimit kolektiv të cilat shpesh parandalojnë arritjen e marrëveshjeve për ristrukturime. Edhe kur përpjekjet për riorganizim nuk rezultojnë të suksesshme, ato nxisin procedura efikase të shitjes së aseteve në likuidim, duke mbrojtur dhe maksimizuar vlerën e shpërndarjes.

Debitorët që konsiderojnë procedurat e falimentimit si një mënyrë për të trajtuar vështirësitë financiare duhet të punojnë në planifikimin dhe në paraqitjen e çështjes së tyre. Për pjesën më të madhe, veçanërisht në nenet 14 dhe 15, LF-ja përcakton kërkesat që

[38] Shikoni Nenin 22 dhe 23 të LF-së.

duhet të plotësojnë debitorët për të kërkuar hapjen e procedurave të falimentimit.

Kur planifikojnë procedurat e falimentimit, debitorët duhet të veprojnë me mirëbesim pasi veprimet e ndërmarra para vendimit për fillimin e një çështje gjithashtu mund të kundërshtohet. Sipas LF-së, çdo transaksion i kryer nga debitori brenda dy vjetësh para fillimit të procedurës së falimentimit mund të kundërshtohet, me kusht që ky transaksion t'i ketë shkaktuar një dëm pasuror debitorit ose t'i ketë dhënë preferencë të pajustificuar një kreditori të caktuar.^[39] Ky rregull është krijuar për të mbrojtur interesat e kreditorëve dhe zbatohet edhe në rastin e kërkesës së kreditorit(ëve) për fillimin e procedurës së falimentimit.

Si rregull i përgjithshëm, ekzistenca e dëmit pasuror duhet të vërtetohet nga personi që kundërshton një transaksion të caktuar. Sidoqoftë, dëmi pasuror prezumohet kur debitori nuk ka marrë asnjë shpërblim në një transaksion të caktuar (p.sh. një dhuratë) ose kur debitori përmbush një detyrim të pasiguruar që nuk është maturuar ende. Për më tepër, transaksionet me palët e lidhura, ato që japin garanci për një borxh para-ekzistues, si dhe ato për përmbushjen e detyrimit të siguruar që nuk është ende i maturuar, krijojnë një prezumim të dëmit nëse nuk provohet e kundërta.

Kërkesa për shmangien e këtyre veprimeve të dëmshme mund të paraqitet nga administratori ose kreditorët. Në rastin e fundit, kreditorët kanë të drejtën të kërkojnë shmangien nëse administratori nuk arrin të kundërshtojë transaksionin problematik dy muaj pasi të jetë informuar për ekzistencën e tij.

Objektivi kryesor i një veprimi shmangieje është ta bëjë masën e falimentimit përsëri të plotë, domethënë ta çojnë atë në të njëjtën situatë sikur veprimi i dëmshëm të mos kishte ndodhur kurrë. Në këtë drejtim, gjykata kompetente mund të:

- (i) urdhërojë kthimin e masës së falimentimit të çdo prone të transferuar si pjesë e transaksionit të shmangur;
- (ii) kërkojë që çdo pasuri të jetë e dhënë në qoftë se ajo përfaqëson në duart e çdo personi zbatimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë të transferuar në këtë mënyrë; ose e parave të transferuara në këtë mënyrë; ose
- (iii) lirojë ose shkarkojë çdo garanci të dhënë nga debitori.

Për më tepër, disa veprime që nuk janë përcaktuar në mënyrë specifike në ligj, mund t'i ndihmojnë debitorët të përjetojnë procedura më të lehta dhe më të suksesshme.

- **Përgatitja:**

Gjatë periudhës përpara dorëzimit të kërkesës së tyre, debitorët duhet të përpiqen të ndërmarrin të gjitha veprimet e arsyeshme të mundshme për të parandaluar falimentimin. Ndërsa ky nuk është një detyrim specifik i diktuar nga LF-ja, veprime të tilla ka të ngjarë të jenë të suksesshme në shumë situata dhe mund të jenë të dobishme edhe nëse nuk janë të tilla, pasi ato dëshmojnë mirëbesimin e debitorit që ka shumë gjasa t'i ofrojë atij mbështetje. Shihni diskutimin më lart.

Debitorët duhet të dorëzojnë një kërkesë brenda 60 ditëve nga dita kur vënë re se janë në paafësi pague. Nëse Debitori nuk respekton këtë detyrim, ai dhe anëtarët e organit

drejtues mund të mbajnë përgjegjësi personalisht për çdo dëm që mund të pësojnë kreditorët për shkak të fillimit të vonuar. Pavarësisht sa më sipër, duhet theksuar se mosdepozitimi brenda kësaj periudhe kohore *nuk* e pengon debitorin ta depozitojë më vonë.

- Depozitoni një kërkesë:

Duke pasur parasysh rëndësinë e fillimit të hershëm të procedurave për shanset e një ristrukturimi të suksesshëm, është praktikë e mirë të hapni procedurat e falimentimit pa vonesë. Sipas pikëpamjes së autorëve, LF-ja nuk parashikon që kërkesat e debitorit duhet (ose mund) të refuzohen nëse paraqiten pas afatit të përcaktuar në “detyrën për të paraqitur kërkesën” (neni 15 i LF-së). Afati 60 ditor i vendosur në të përcakton përgjegjësinë e administratorëve, por, pasi të ketë përfunduar, çështja e falimentimit akoma mund të hapet nëse përmbushen kërkesat ligjore. Kjo është rruga e shtruar nga LF-ja e cila lejon depozitimin e kërkesës së falimentimit të debitorit në afërsi të paaftësisë paguese (neni 14) dhe që kërkon thjesht shfaqjen e paaftësisë paguese për të hapur një çështje (neni 17).

Neni 14 ofron një listë shteruese të dokumenteve të nevojshme për të mbështetur kërkesën e një debitorit për të filluar procedurat e falimentimit. Ndërsa kjo listë është relativisht e gjatë, ajo përmban kërkesat themelore që zakonisht kërkohen në legjislacione të ngjashme.^[40]

Një komponent i rëndësishëm i procedurave të suksesshme të falimentimit sipas LF-së është bashkëpunimi i debitorit me administratorin dhe me kreditorët e tij. Një bashkëpunim i tillë nuk pritët thjesht nga sistemi ligjor në mënyrë që të jap rezultate më të mira, por LF-ja gjithashtu e kthen atë në një detyrë që ka një debitor dhe menaxherët e tij. Detyra përfshin çdo rrethanë të rëndësishme në lidhje me procedurat e falimentimit.^[41]

[40] Lista e dokumenteve të kërkuara nga LF-ja në Nenin 14 është si më poshtë:

- raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit;
- ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;
- bilancin dhe pasqyrat financiare për tri vitet e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për aq sa kjo periudhë është;
- listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë:
 - i. vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;
 - ii. vlerën aktuale të tregut në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;
 - iii. vendndodhjen e pasurive; dhe/ose të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci, ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;
- listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;
- listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;
- listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;
- listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;
- listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur.

[41] Për shembull, detyra për të bashkëpunuar zbatohet për veprimet e ndodhura që dy vjet përpara fillimit të procedurës së falimentimit. Transaksione të tilla mund të konsiderohen të pavlefshme në kushte të caktuara, p.sh. kur transaksione të tilla shkaktojnë dëme në masën e falimentimit

V. EFEKTET E HAPJES SË PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Kurdo që gjykata vendos për hapjen e një procedure falimentimi, vendimi i saj për fillimin duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:^[42]

- *Informacione identifikimi për debitorin*, siç janë emri, mbiemri, data e lindjes, numrin personal të identifikimit ose numri e personit të tatueshëm;
- *Informacione identifikimi për administratorin* – qoftë falimentimi^[43] ose mbikqyrës^[44]–, duke përfshirë emrin, mbiemrin, numrin personal të identifikimit, numrin e liçencës dhe një tregues nëse është administrator falimentimi ose administrator i mbikqyrjes;
- *Një urdhër që parashikon publikimin e një kopjeje të formës së shkurtër të vendimit* në faqen zyrtare të internetit të gjykatës, në QKB dhe në Fletoren Zyrtare;
- *Një ftesë për çdo kreditor të debitorit për të verifikuar pretendimet e tij* me administratorin e falimentimit ose të mbikqyrjes brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në QKB;
- me administratorin e falimentimit ose të mbikqyrjes brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit; e cila duhet të jetë brenda 120 ditëve nga data e vendimit;
- *Listën e kreditorëve, nëse është e disponueshme.*^[45] Bazuar në këtë listë, gjykata e falimentimit mund të caktojë një komitet të përkohshëm të kreditorëve për të mbikqyrur procedurat (shih më poshtë), përveç nëse konsiderohet i papërshtatshëm për shkak të natyrës së vogël të biznesit ose faktorëve të tjerë.

V.I. Efektet kryesore të Vendimit për Hapjen e Procedurave të Falimentimit

Hapja e çështjes së falimentimit ka pasoja shumë të rëndësishme si për debitorin ashtu edhe për kreditorët e tij:

- *E drejta e debitorit për administrimin dhe disponimin e pasurisë është e kufizuar:* nëse debitori paraqet kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit, e drejta e debitorit për administrimin dhe disponimin e pasurisë është e kufizuar në veprimet e zakonshme të administrimit (shpesh i përshkruar si debitori në posedim). Një

[42] Shikoni Nenin 29 të LF-së.

[43] LF-ja e përkufizon 'administratorin e falimentimit' si 'administratori i caktuar nga gjykata e falimentimit në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas hapjes së saj kur zëvendëson debitorin në administrimin dhe drejtimin e veprimtarisë.'

[44] LF-ja e përkufizon 'administratorin e mbikqyrjes' si 'administratorin e caktuar nga gjykata e falimentimit me vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit ose më pas për mbikqyrjen e debitorit dhe sipas parashikimeve të këtij ligji për autorizimin e akteve të administrimit dhe detyrave të tjera.'

[45] Kjo listë është e disponueshme kur një vendim për të filluar çështjen u nxit nga depozitimi vullnetar i kërkesës nga një debitor.

administrator i mbikqyrjes do të duhet të autorizojë çdo veprim të disponimit që është jashtë objektit të veprimtarisë së zakonishtme tregtare.^[46] LF-ja lejon largimin nga skenari të debitorit në posedim pas kërkesës së kreditorit (shikoni më poshtë). Nga ana tjetër, një administrator falimentimi ngarkohet të administrojë pasuritë e debitorit në rastet e kërkesave të kreditorit për të hapur një çështje. Përfundimisht, nëse ndonjë veprim i debitorit nuk arrin të ndjekë urdhrin e LF-së për administrimin dhe disponimin e pasurisë dhe u shkakton dëme masës së falimentimit ose kreditorëve, një veprim i tillë mund të kundërshtohet (shikoni më poshtë).

- *Debitorit i lejohet të vazhdojë veprimtarinë e tij profesionale:* këtë të drejtë e gëzon debitori përveç nëse pezullimi i veprimtarisë profesionale të debitorit konsiderohet se është në interesin më të mirë të kreditorëve;
- *Pas fillimit të procedurës së falimentimit, një moratorium ose pezullim, zbatohet për depozitimin e padive nga kreditorët, si dhe për çdo procedurë ekzekutimi, tashmë në proces ose që do të fillojë.* Një moratorium i tillë i drejton kreditorët para hapjes së procedurës së falimentimit të paraqesin pretendimet e tyre në procedurën e falimentimit^[47]
- *Si rregull, fillimi i procedurës së falimentimit nuk ka asnjë ndikim në vazhdimësinë e një kontrate që nuk është përmbushur plotësisht nga debitori dhe nga pala tjetër e saj.^[48] Kontrata nuk mund të zgjidhet më herët për shkak të fillimit të procedurës së falimentimit; çdo dispozitë në kundërshtim me këtë është e pavlefshme Përndryshe, nëse një palë në kontratë ka përmbushur plotësisht detyrimet e saj, por debitori nuk ka arritur ta bëjë këtë, pala tjetër mund të ngrejë një pretendim si një kreditor falimentimi.*
- *Veprimet në data fikse dhe veprimet me titujt financiarë:* kur dorëzimi i mallrave ose kryerja e një transaksioni të natyrës financiare me çmimin e tregut, duhet të kryhet brenda një afati të caktuar dhe ky afat përfundon pas fillimit të procedurës së falimentimit, përmbushja e detyrimit në natyrë nuk mund të kërkohet. Mund të paraqitet një pretendim për dëmin e shkaktuar për shkak të mos përmbushjes së tij.^[49]
- *Ndalimi i zgjidhjes së marrëveshjeve të qirasë:* një marrëveshje qiraje që ka debitorin si qiramarrës nuk mund të zgjidhet nga qiradhënësi pasi është kërkuar fillimi i procedurës së falimentimit për shkak të mos pagesës së qirasë para fillimit të procedurës së falimentimit ose për shkak të përkeqësimit të pozicionit financiar të debitorit. Sidoqoftë, mospërmbushja e detyrimeve të qirasë pas fillimit të procedurës së falimentimit i jep qiradhënësit të drejtën e zgjidhjes së kontratës.^[50]
- *Vazhdimi i kontratave të punës:* fillimi i procedurave të falimentimit nuk ndikon në vazhdimin e kontratave të punës, megjithatë administratori i falimentimit ose i mbikqyrjes mund të sugjerojë ndryshimin ose zgjidhjen e tyre.^[51]

[46] Shikoni nenin 60 të LF-së. Përfundimisht, një administrator i mbikqyrjes mund të kërkojë gjithashtu heqjen e kompetencave të administrimit, plotësisht ose pjesërisht, të një debitori.

[47] Shikoni Nenin 69 të LF-së.

[48] Shikoni Nenin 72 të LF-së.

[49] Shikoni Nenin 74 të LF-së.

[50] Shikoni Nenin 75 të LF-së.

[51] Shikoni Nenin 78 të LF-së.

- *Debitori ka të drejtë që shpenzimet minimale të jetesës të sigurohen nga masa e falimentimit: shpenzimet e jetesës duhet të plotësojnë nevojat themelore të debitorit, fëmijëve të mitur nën përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e debitorit, përfshirë ato që ndjekin shkollën deri në moshën 25 vjeç, të gruas dhe ish-gruas, sipas detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.^[52]*

Kufizimi i administrimit dhe disponimi i pasurive

Siç përmendet më sipër, një listë e re rregullash zbatohet mbi aftësinë për të administruar dhe disponuar pasurinë e debitorit pas paraqitjes së një kërkesë dhe gjykata deklaron procedurat e falimentimit të hapura. Një faktor kyç që përcakton mënyrën në të cilën mund të ndodhë administrimi dhe disponimi lidhet me paraqitjen e kërkesës. Sipas LF-së, debitorët që paraqesin një kërkesë zakonisht u jepen të drejta për të vazhduar të kryejnë aktivitetin e tyre me kufizime të caktuara (Neni 60.1).

Shembull: *Abla Tables Shpk është në biznesin e shitjes së tavolinave për konsumatorët. Gjatë 5 viteve të fundit ajo bleu tavolina vetëm nga dy prodhues shqiptarë. Pas paraqitjes së kërkesës për procedurat e falimentimit Abla vendosi të futej në shitjen e pajisjeve elektrike të prodhuara në Itali. Shoqëria po planifikon të shpenzojë rreth 20% të buxhetit të mbetur të shpenzimeve për blerjen e këtyre produkteve.*

Përgjigje: *Abla mund të vazhdojë të blejë tavolinat nga prodhuesit me të cilët ka bërë tregti në të shkuarën. Ndoshta mund të blejë të njëjtat produkte nga prodhuesit e tjerë. Sidoqoftë, nuk mund të angazhohet në aktivitete të reja biznesi pa miratimin e administratorit të mbikqyrjes.*

Së pari, debitorët në këtë pozicion mund të vazhdojnë dhe operojnë biznesin e tyre në veprimtarinë e zakonshme tregtare. Nuk ka asnjë përcaktim të këtij termi në LF-në. Sidoqoftë, supozohet se termi përfshin aktivitetet dhe transaksionet që janë të zakonshme për funksionimin e biznesit bazuar në përvojën e kaluar. Së dyti, ata do të duhet të mbikqyren nga administratori dhe të këshillohen me administratorin për çdo veprim disponimi që është jashtë veprimtarisë së zakonshme tregtare.

Debitorët nuk kanë të drejtë të prekin pasuritë që janë objekt i pretendimeve të kreditorëve të siguruar pa autorizimet e mëparshme të administratorit të mbikqyrjes. Për më tepër, edhe nëse debitorët janë marrë më parë gjatë veprimtarisë së zakonshme tregtare të tyre, pasi të fillohen procedurat e falimentimit, pasuri të tillë konsiderohen të jenë jashtë objektit të veprimtarisë së zakonshme tregtare.

Shembull: *Supozoni se Abla Shpk, të kishte një kamion që ishte blerë me një kredi nga Banka Beta dhe që i nënshtrohet një barre siguroese sipas Ligjit shqiptar për Barrët Siguroese. Supozoni se Abla Shpk është e interesuar të shesë kamionin në mënyrë që të paguajë disa nga borxhet e saj.*

Përgjigje: *Abla nuk do të jetë në gjendje të shesë kamionin nëse administratori nuk e miraton transaksionin. Arsyeja është se Banka Beta është një kreditor i siguruar dhe kamioni është kolaterali i huasë së saj për Abla-n.*

Siç u përmend më lart, e drejta e debitorit për administrim në veprimtarinë e zakonshme tregtare është e kufizuar në situatat kur debitori është kërkuesi. Në rrethana të caktuara, debitori mund ta humbasë këtë privilegj, për shembull, kur gjykata mund të përcaktojë që sjellja e debitorit paraqet rrezik për masën e falimentimit dhe interesat e kreditorëve. Kur një kërkesë paraqitet nga një kreditor, administrimi i masës së falimentimit i takon administratorit të falimentimit.

Veprimet e debitorit të ndërmarra kundër parimeve të lartpërmendura mund të kundërshtohen në gjykatë. Administratorët ose një ose më shumë kreditorë që bashkërisht zotërojnë 10 përqind të pretendimeve totale mund të bëjnë kërkesë për shmangien e veprimeve të debitorit në kundërshtim me rregullat e administrimit dhe disponimit kur veprime të tilla janë të dëmshme për masën e falimentimit ose për kreditorët. Pas një kërkesë të tillë gjykata mund të pezullojë veprimet e kundërshtuara dhe mund të anulojë pasojat e tyre.

Në rast se fillohen procedurat e likuidimit, debitori humbet të drejtën të administrojë biznesin e tij dhe të disponojë pronën e tij. Administratori do ta vendosë veten në vendin e debitorit dhe do të jetë përgjegjës për funksionimin e të gjithë sipërmarrjes.^[53]

Pasuritë e Përfshira

Kur procedurat e falimentimit fillojnë, të gjitha pasuritë janë objekt i procedurave dhe njihen si masa e falimentimit.

Masa e falimentimit përfshin:

... tërësinë e pasurive dhe të drejtave të debitorit në datën e fillimit të procedurës së falimentimit, si dhe pasurive dhe të drejtave të fituara gjatë kësaj procedure, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë tij, përveç pasurive që janë të përjashtuara nga ekzekutimi i detyrueshëm, siç parashikohet në Kodin e Procedurës Civile.

Shembull:

Pasuritë e mëposhtme mund të jenë pjesë e një mase falimentimi:

- pasuria që është në zotërimin e debitorit dhe që i përket atij;
- pasuria që i përket debitorit, por në pronësi të dikujt tjetër;
- disa pasuri që debitori ka dhënë së fundmi^[54];
- pasuri ose llogaritë e arkëtueshme që i detyrohen debitorit;
- të ardhurat nga pasuria e debitorit (të tilla si shitje, qira etj.);
- Kuotat e debitorit në partneritet në një biznes ose pasuri martesore.

[53] Shikoni Nenin 136 të LF-së.

[54] Shikoni më sipër për veprimet e shmangies.

Pasuritë e Përrjashtuara

Debitorët të cilët janë persona fizikë mbrohen nga ligji shqiptar kundrejt rrethanave që do e bënin jetën e tyre shumë të vështirë në rast të falimentimit. Ligji shqiptar mbron debitorët e tillë duke përjashtuar disa pasuri nga dhe likuidimi. Ky përjashtim zbatohet përpara dhe gjatë procedurave të falimentimit. Lista e mëposhtme jep një përmbledhje të llojit të pasurive që nuk mund ti sekuestrohen debitorit:

- sendet e përdorimit personal për të jetuar, siç janë rrobat ose tualetet;
- ushqimi dhe karburanti i nevojshëm deri në tre muaj;
- dekorime dhe suvenire, letra, dokumente të familjes dhe libra profesional;
- sendet artistike dhe shkencore për përdorim profesional;
- 3 mijë metra katrorë tokë për fermerët që e kanë mjet jetese atë tokë dhe disa kafshë të përdorura për të jetuar;
- mbështetje minimale për nënat beqare dhe familjet me shumë fëmijë;
- paga minimale neto ose ndihma sociale siç parashikohet me ligj.

V.II. Paraqitja e pretendimeve nga Kreditorët

Pasi janë hapur procedurat e falimentimit, Kreditorët pritet të jenë proaktivë në mënyrë që të marrin pjesë në procedurën e falimentimit. Në të vërtetë, për t'u njohur brenda një procedure falimentimi, kreditorët, pretendimi i të cilëve u ngrit përpara fillimit të procedurës së falimentimit, d.m.th kreditorët e falimentimit, duhet të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim te administratori i falimentimit ose i mbikqyrjes.^[55]

a. Llojet e Kreditorëve

Thirrja për kreditorët për të paraqitur një pretendim kundër debitorit përfshihet në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit. Këto pretendime duhet të paraqiten brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit në fjalë në QKB.

Lloji ose klasa e pretendimeve që kreditorët mund të paraqesin mund të klasifikohet në katër grupe kryesore, duke përfshirë nga pretendimet e siguruara deri tek fundore. Me pak fjalë, një kreditor që ka një lloj të caktuar pretendimi konsiderohet kreditor i këtij lloji. Si shembull, një kreditor që ka një *pretendim të pasiguar* konsiderohet një *kreditor i pasiguar*. Në përputhje me LF-në, një përshkrim i shkurtër i secilit lloj kreditori vijon më poshtë:

- **Kreditorët e Siguar.** Këta kreditorë përkufizohen në Nenin 3 si ata që zotërojnë të drejta të vlefshme në pasuritë e një debitori të siguar me anë të pengut, hipotekës ose formë tjetër të garancisë, të njohur nga Kodi Civil shqiptar ose nga ligjet e veçanta. Kreditorët konsiderohen të siguar vetëm në atë masë sa pretendimet

e tyre mund të përmbushen me të ardhurat e shitjes së kolateralit të vendosur. Çdo pjesë e mbetur e papaguar u siguron këtyre kreditorëve një pretendim të pasiguruar kundrejt masës së falimentimit.^[56]

- **Kreditorët e preferuar.** Kreditorët në këtë grup kanë një kategori të veçantë pretendimesh, përfshirë pretendimet për ndërprerjen e punësimit, pretendimet për dëmtimet personale të punonjësve ose dëmet e jetës ose shëndetit.^[57]
- **Kreditorët e Pasiguruar.** Ky lloj i kreditorëve përkufizohet duke përdorur një kriter eliminimi, ku çdo kreditor, qoftë personat fizikë ose juridikë të cilët nuk klasifikohen si të siguruar, të preferuar ose fundorë, hyjnë në këtë kategori.^[58]
- **Kreditorët Fundorë.** Kjo kategori përfshin ata kreditorë që kanë pretendime për penaltete për pagesa të vonuara, të akumuluar para fillimit të procedurës së falimentimit, gjopa, shlyerjen e kredive të kontraktuara me palët e lidhura me debitorin ose ato që palët kanë rënë dakord t'i klasifikojnë si të fundorë.^[59]

Përveç kreditorëve të lartpërmendur të falimentimit, kreditorët, pretendimet e të cilëve u ngritën pas fillimit të procedurës së falimentimit, konsiderohen se i përkasin një kategorie të ndryshme kreditorësh, asaj të *kreditorëve të procedurës së falimentimit*. Këta kreditorë paguhen pasi pretendimet e tyre bëhen të maturueshme^[60] për të nxitur vazhdimësinë e veprimtarisë. Dy lloje pretendimesh bëjnë pjesë në këtë kategori:

- Shpenzimet që lidhen me procedurën e falimentimit, siç janë shpenzimet gjyqësore, shpërblimi i administratorit dhe shpenzimet e miratura të komitetit të kreditorëve.
- Shpenzimet administrative të procedurës së falimentimit, siç janë:
 - a. Shpenzimet që rrjedhin nga kryerja e detyrave të administratorit.
 - b. Detyrimet e mbështetjes dhe mirëmbajtjes të shkaktuara pas fillimit të procedurës së falimentimit, kur debitori është individ.
 - c. Huatë e dhëna debitorit me kërkesën e tij dhe të cilat janë miratuar nga administratori i mbikqyrjes ose të cilat janë kërkuar nga administratori pas fillimit të falimentimit.
 - d. Shumat e detyruara të debitorit bazuar në kontratat e lidhura nga administratori i falimentimit ose të cilat janë miratuar nga administratori i mbikqyrjes pas fillimit të procedurës së falimentimit.
 - e. Çdo përgjegjësi e lindur pas fillimit të procedurës së falimentimit, si rezultat i një pasurimi të padrejtë të debitorit.

b. Paraqitja e një pretendimi

Çdo pretendim duhet të dorëzohet te administratori me shkrim nga çdo person që

[56] Shikoni Nenin 37 të LF-së.

[57] Shikoni Nenin 38 të LF-së.

[58] Shikoni Nenin 39 të LF-së.

[59] Shikoni Nenin 40 të LF-së.

[60] Shikoni Nenin 35 dhe 144 të LF-së.

pretendon të jetë një kreditor në një procedurë falimentimi.^[61] Paraqitja e pretendimit duhet të shoqërohet me të gjitha dokumentet që vërtetojnë pretendimin dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- (i) Baza ose burimi nga i cili është ngritur pretendimi;
- (ii) Shuma e pretendimit;
- (iii) Nëse paditësi është një kreditor i siguruar ose i preferuar.

Në paraqitjen e pretendimeve të tyre, kreditorët duhet të mbajnë parasysh sa më poshtë:

- Shuma e pretendimit duhet të përfshijë shumën tashmë të maturuar dhe gjithashtu ato të maturueshme në të ardhmen. Për të vetmin qëllim për të vërtetuar pretendimet e tyre, hapja e procedurës së falimentimit i bën të gjitha pretendimet ndaj debitorit menjëherë të maturueshme.^[62]
- Një pretendim ndaj debitorit i cili nuk shprehet në vlerë monetare duhet të shprehet në terma monetarë.^[63]
- Një pretendim ndaj debitorit në monedhë të huaj duhet të konvertohet në monedhën shqiptare në përputhje me kursin zyrtar të këmbimit në datën e fillimit të procedurës së falimentimit.

Sipas LF-së, përparësia u jepet kreditorëve të siguruar në vend të kreditorëve të preferuar, kreditorëve të pasiguruar dhe kreditorëve fundorë. Kreditorët e siguruar kanë përparësi mbi të gjithë kreditorët e tjerë të falimentimit pavarësisht nga lloji i kolateralit, d.m.th. një hipotekë, barrë sigurimi, kolateral financiar, etj. Këta kreditorë të siguruar kanë të drejtë të kenë përparësi në masën që kolaterali përkatës shlyen detyrimin e siguruar ndërsa pjesa tjetër e detyrimit konsiderohet një pretendim i pasiguruar. Pretendimet e kreditorëve dhe radha e përparësive në shpërndarje për secilën kategori dhe klasë të kreditorëve në përputhje me LF-në është si më poshtë:

- pretendimet që rrjedhin nga transaksionet financiare të siguruar deri në çmimin e pasurisë së veçantë të siguruar;
- pretendimet e kreditorëve të preferuar që paraqesin pretendimet që lindin nga:
 - zgjidhja e kontratave të punësimit deri në 3 muaj përpara paraqitjes së kërkesës për falimentim, duke përfshirë sigurimin shëndetësor dhe lejen e lindjes, të cilat nuk kalojnë shumën 500,000 Lekë (afërsisht 3,700 Euro);
 - shpenzimet e jetesës që lindin përpara fillimit të procedurës së falimentimit kur debitori i falimentimit është një person fizik;
 - pretendimet e punonjësve për dëme që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës;
 - pretendimet për shpërblimin e dëmit ndaj jetës dhe shëndetit, të shkaktuar nga debitori i falimentimit përpara fillimit të procedurës së falimentimit; dhe
 - pretendimet tatimore të lindura një vit përpara fillimit të procedurës së falimentimit;

[61] Administratori mund të autorizojë depozitimin elektronik të pretendimeve.

[62] Shikoni Nenin 86 të LF-së.

[63] Shikoni Nenin 91 të LF-së.

- pretendimet e kreditorëve të pasiguruar;
- pretendimet e kreditorëve fundor, të cilat sipas përkufizimeve ligjore janë kreditor që kanë pretendime për:
 - sanksionet për pagesa të vonuara;
 - detyrime administrative, penale dhe civile;
 - shlyerjen e kredive nga personat e lidhur me debitorin; dhe
 - kredinë e renditur të fundit sipas marrëveshjes së kreditorit dhe debitorit; dhe
- pretendimet e ortakëve dhe aksionarëve sipas llojit të shoqërisë.

c. Lista e Kreditorëve

Pas paraqitjes së pretendimeve, administratori ngarkohet të rishikojë dhe klasifikojë ato. Duke vepruar kështu, ai duhet t'i regjistrojë ato pretendime në listën e ashtuquajtur të kreditorëve, përveç atyre pretendimeve që ai sugjeron që duhet të refuzohen, të cilat nga ana tjetër, duhet të përfshihen në një listë të veçantë.^[64] Pretendimet e mëposhtme përfshihen me detyrim në listë nga administratori i falimentimit ose i mbikqyrjes:

- a) pretendimet, të pranuar shprehimisht me vendimin e gjykatës ose vendimin e arbitrazhit;
- b) pretendime, të njohura nga një vërtetim zyrtar të lëshuar nga autoriteti publik përkatës;
- c) pretendimet e siguruar nga të drejta të regjistruara në regjistrin publik.

Listat e lartpërmendura duhet të përmbajnë informacione mbi identitetin e kreditorit, shumën e pretendimit dhe klasifikimin e tij si të siguruar, të preferuar, të pasiguruar dhe përfundimtar.

Listat duhet të paraqiten në gjykatë brenda 20 ditëve nga afati i fundit për paraqitjen e pretendimeve. Çdo pretendim i paraqitur pas përfundimit të kësaj periudhe do të konsiderohet i *vonuar*, përveç nëse paraqiten mbi një vit nga fillimi i procedurës së falimentimit. Në këtë rast, këto pretendime nuk do të merren fare parasysh gjatë procedurës. Kreditorët me pretendime të vonuara, nga ana tjetër, humbasin të drejtën për të marrë pjesë në çdo vendim ose shpërndarje, që ka ndodhur tashmë në momentin e paraqitjes. Dorëzimi i listës shpallet publikisht në QKB dhe Fletoren Zyrtare.

d. Kundërshtimi i pretendimeve të paraqitura

Si rregull, pretendimet e kreditorit që janë të përfshira në listën e kreditorëve nga administratori dhe që nuk janë kundërshtuar nga debitori ose ndonjë kreditor tjetër, njihen dhe vlerësohen si të verifikuara nga gjykata e falimentimit.^[65]

[64] Shikoni Nenin 87 të LF-së.

[65] Shikoni Nenin 90 të LF-së. Lista e kreditorëve mund të kundërshtohet nga kreditorët të cilët kanë kërkuar pranimin e pretendimeve të tyre nga administratori i falimentimit ose i mbikqyrjes si edhe nga ata, pretendimi i të cilëve u

Kreditorët që paraqitën pretendimet e tyre për verifikim dhe debitori ^[66] mund të paraqesin kundërshtim për çdo pretendim tjetër. Kundërshtimet mund t'i referohen përfshirjes ose mos përfshirjes së një pretendimi në listën e kreditorëve, shumën e pranuar ose klasifikimin e kërkesës. Kundërshtimet duhet të paraqiten me shkrim në gjykatën e falimentimit dhe të shoqërohen me dokumente që vërtetojnë kundërshtime të tilla, brenda 10 ditëve nga Data e Publikimit.

Si rregull i përgjithshëm, kundërshtimi i një pretendimi nuk pezullon zhvillimin normal të procedurës së falimentimit, përveç nëse pretendimet e kundërshtuara prekin më shumë se 25% të pretendimeve të përgjithshme të përfshira në listën origjinale të kreditorëve.

V.III. Publikimet dhe njoftimet

Një nga aspektet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me procedurat e falimentimit është publikimi ose botimi i informacionit në mënyrë që të shpërndahet tek të gjitha palët e interesuara. Publikimi i njoftimeve të ndryshme të gjykatës është i rëndësishëm për të lehtësuar aksesin e publikut në informacion.

Në nenin 6 parashikohet:

Procedura e falimentimit është publike, brenda kufijve të parashikuar nga ky ligj dhe që palët pjesëmarrëse në procedurën e falimentimit kanë të drejtë të informohen mbi procedurën, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj.

Duhet të ketë një ekuilibër midis të drejtës së publikut për të ditur për procedurat dhe nevojës për të shmangur shkeljen e panevojshme të së drejtës së debitorit për privatësi, megjithëse debitori nuk ka të drejtë të vendosë për publikimin ose jo.

Informacioni që publikohet përfshin:

- Fillimin,^[67] pezullimin ose përfundimin e procedurës së falimentimit.
- Revokimin e vendimit të fillimit nga një gjykatë më e lartë.
- Njoftimet në lidhje me kufizimin e debitorit për ta disponuar ose administruar pasurinë e tij.
- Llogaritë që administratori u paraqet kreditorëve. Debitori ka të drejtë të kundërshtojë llogaritë përpara se ato të publikohen.
- Vendimin për thirrjen e mbledhjes së kreditorëve.
- Përfundimin dhe depozitimin e listës së kreditorëve.
- Vendimin për miratimin ose refuzimin e planit të riorganizimit.
- Shkarkimin e borxheve të caktuara të një personi fizik si edhe revokimi i shkarkimit në fjalë.

sugjerua që të refuzohej.

[66] LF-ja e përkufizon "kreditor i falimentimit" si 'kreditori pretendimet e të cilit kanë lindur përpara fillimit të procedurës së falimentimit.'

[67] Duhet të theksohet se fillimi i procedurës duhet të regjistrohet edhe në Regjistrin e Tokës në rast se masa e falimentimit përfshin të drejtat e pasurisë së patundshme. Neni 32 pika 3 i LF-së parashikon gjithashtu regjistrime në regjistrat e tjerë publik që kanë të bëjnë me të drejtat e pasurisë së debitorit si Regjistri për Barrët Siguruese.

QKB-ja do të ngarkohet me publikimin e informacionit siç kërkohet në LF-në.^[68] Publikimi në këtë Qendër konsiderohet të jetë njoftim i mjaftueshëm për çdo person që është palë e interesuar në procedurë. Publikimi gjithashtu mund të bëhet në gjykatë dhe në Fletoren Zyrtare.

Gjykata mund të urdhërojë publikimin e informacionit në vende të tjera. Në këtë kuadër administratorit mund ti kërkohet të publikojë njoftimet dhe shpalljet në faqen e internetit të debitorit. Nuk ka detaje specifike në ligj për karakteristikat e publikimeve të tilla si përmasa, vendndodhja dhe koha. Në rrethana të caktuara, gjykata do të duhet të vendosë se si të interpretojë këtë dispozitë.

Më poshtë është një shembull i informacionit që gjykata mund të publikojë ose/dhe t'i kërkojë debitorit të publikojë:

Njoftimi për Fillimin e Procedurës së Falimentimit:

Data: 1 janar 2021

Në lidhje me: Kërkesën e ABC Shpk për të nisur Procedurën e Falimentimit

ID Nr.: 333333

Aktiviteti: Dhënia me qira e Makinerive Bujqësore

Adresa : Rruga 1, kati i 2, Tiranë, Shqipëri

NJOFTIM PËR TË GJITHË personat e interesuar. Nëpërmjet këtij publikimi njoftoheni në Qendrën Kombëtare të Biznesit Shqiptar që debitori i përmendur më sipër ka paraqitur një kërkesë për falimentim në bazë të Ligjit Shqiptar të Falimentimit dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga çdo procedurë ekzekutimi jashtë Ligjit Shqiptar të Falimentimit.

URDHËROHET që, në bazë të Ligjit Shqiptar të Falimentimit, nga koha dhe data e depozitimit të kësaj çështje, të gjithë personat, agjentët e tyre, punonjësit dhe avokatët nuk do të fillojnë ose të vazhdojnë ndonjë çështje ose të ekzekutojnë të ardhurat ose pagat e debitorit, si edhe atyre u ndalohet rimarrja e pasurisë së debitorit ose ato që janë nën kontrollin e tij. Personave të tillë u ndalohet më tej të shqetësojnë, ngacmojnë ose bezdisin Debitorin. Të gjitha çështjet që lidhen me sa më sipër bëhen juridiksioni ekskluziv i Gjykatës Shqiptare të Falimentimit.

V.IV. Ndërhyrja e prokurorit në procedurat e falimentimit

Ndërsa procedurat e falimentimit nuk kanë natyrë penale në vetvete, prokurori ka një rol të rëndësishëm pasi rezultatet e hetimit mbi pasurinë e debitorit mund të ndikojnë në hapjen ose mbylljen e procedurave të falimentimit.

Çelja ose jo e procedurës, kur debitori ka pasuri të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e procesit të falimentimit është shumë e diskutueshme. Nga njëra anë, gjykatat dhe autoritetet nuk duhet të shpenzojnë burime që merren me raste ku nuk ka asgjë për të rikuperuar, të tilla si në çështjet e ashtuquajtura “pa pasuri”. Nga ana tjetër, është

[68] Shikoni Nenin 12 të LF-së.

thelbësore t'u sigurohet kreditorëve një mundësi për të kundërshtuar transaksionet, në rast se debitori ka kryer mashtrim ose ka transferuar pasuri te të afërmit, etj. Kjo është arsyeja pse Neni 20 i LF-së, në vend që të përfundojë çështjen e falimentimit (siç bëri legjislacioni i mëparshëm), u siguron kreditorëve mundësinë për të kundërshtuar mbylljen e çështjes, në ato raste kur ka pasurit të debitorëve që mund të jenë transferuar. Nëse paraqitet ai kundërshtim, atëherë LF-ja parashikon ndërhyrjen e prokurorit përmes Nenit 20.3 i si më poshtë:

“Gjykata e Falimentimit, brenda 5 ditëve nga mbarimi i afatit të kundërshtimeve, i komunikon prokurorit çdo pretendim të palëve, të cilat kanë arsye të bazuara për nevojën e kryerjes së hetimeve të mëtejshme mbi veprimet e debitorit, dhe pezullon procedurën për 6 muaj për kryerjen e hetimit.”

Siç parashikohet më sipër në rast të kundërshtimeve në lidhje me mbylljen e procedurave për shkak të mungesës së pasurisë së debitorit, gjykata e falimentimit pezullon procedurat dhe i paraqet dokumentacionin (d.m.th. pretendimin e palëve) prokurorit. Duket se veprimet që do të hetohen nga prokurori referohen në pretendimin(et) përkatëse të paraqitura nga palët që kundërshtojnë mbylljen e procedurave të falimentimit.

Prokurori do të kryejë hetime kur ekziston dyshimi se debitori nuk ka treguar disa prej pasurive të tij ose të saj siç parashikohet në Nenin 20.2.a. ose nëse kërkohet hetim i mëtejshëm në lidhje me veprime të caktuara të ndërmarra nga debitori për të transferuar pasurinë e tij, të cilat mund t'i nënshtrohen të drejtës së shmangies siç përcaktohet në nenet 79 deri 81 të LF-së.

Për më tepër, veprimet që do të hetohen nga prokurori duhet të përmbushin kushtet e parashikuara në Nenin 79.1 të LF-së domethënë të jenë kryer brenda periudhës së dy viteve të fundit dhe të kenë shkaktuar një dëm pasuror siç e parashikon LF-ja ose i kanë dhënë preference të pajustificuar një kreditori.

Sipas Nenit 79.1 të LF-së:

‘Të gjitha veprimet e debitorëve, të kryera brenda një periudhe prej 2 vitesh përpara fillimit të procedurës së falimentimit, mund të kundërshtohen në qoftë se i kanë shkaktuar një dëm pasuror debitorit ose i kanë dhënë preferencë të pajustificuar një kreditori të caktuar’

Një dëm pasuror ekziston në ato raste kur:

- debitori kryen veprime për të cilat vlera e marrë, në para ose ekuivalente me ato, është në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se vlera në para ose ekuivalente me ato, e dhënë nga pala tjetër ndaj debitorit;
- debitori ka bërë një dhuratë ose ka kryer veprime me kushte që nuk i japin debitorit asnjë përfitim ose debitori përmbush një detyrim të pasiguruar, i cili nuk ishte maturuar përpara fillimit të procedurës së falimentimit;
- debitori ka kryer veprimet me personat e lidhur^[69];

[69] Sipas LF-së “Person i lidhur me debitorin” nënkupton: a) Kur debitori është person fizik: i) bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e debitorit ...; ii) paraardhësit ose pasardhësit e debitorit ose të bashkëshortit/es/ bashkëjetuesit/es, vëllezërit, motrat dhe të afërmit e tjerë të debitorit deri në shkallën e dytë me lidhje gjaku dhe bashkëshortët /bashkëjetuesit e këtyre personave; iii) bashkëshortët ose bashkëjetuesit e secilit prej personave të përmendur në nënparagrafin “ii”, iv) persona të cilët, për shkak të ndonjë marrëdhënieje me debitorin, janë në dijeni të informacionit konfidencial mbi gjendjen financiare të debitorit. b) Kur debitori është person juridik: i) çdo

- është dhënë një garanci për të siguruar një detyrim ekzistues ose një detyrim të ri që zëvendëson detyrimin e mëparshëm, kur detyrimi i mëparshëm nuk ishte i siguruar;
- është përmbushur një detyrim i siguruar që nuk ishte shlyer para fillimit të procedurës së falimentimit.

Disa shembuj të veprimeve të kryera nga debitori të cilat mund t'i nënshtrohen të drejtës së shmangies janë: ekzekutimi i kontratave të shërbimit kur debitori merr një çmim shumë më të ulët se çmimi i tregut; dhurimi i pasurisë nga debitori te personat e lidhur; transferimi i shumave të parave nga debitori tek një person i tretë pa ndonjë arsye ekonomike; shitja e mallrave nga debitori me një çmim më të ulët se vlera e tregut.

Prokurori duhet të hetojë nëse veprimet e mësipërme të kryera nga debitori kanë shkaktuar një dëm pasuror ose i kanë dhënë preferencë të pajustificuar një kreditori, pra nëse i nënshtrohen të drejtës së shmangies në mënyrë që të mundësojnë rikthimin e pasurive në masën e falimentimit dhe ti japë informacion gjykatës së falimentimit për të dhënë një vendim të informuar për hapjen ose përfundimin e procedurave.

Roli i përcaktimit nëse një transaksion objekt kundërshtimi bëhet i vlefshëm i mbetet gjyqtarit. Debitori, nga ana tjetër duhet të provojë njëherë nga sa më poshtë për të shmangur një vendim gjykate që transaksioni është i pavlefshëm:

- a. debitori vepron në mirëbesim dhe pritët të përfitojë nga transaksioni;
- b. debitori vepron sipas rrjedhës së zakonshme të biznesit;
- c. garancitë dhe të drejtat e dhëna nga debitori sigurojnë kontrata financiare; ose
- d. transaksioni është pjesë e një marrëveshjeje të riorganizimit të përshpejtuar.

Sipas Nenit 20.4 të LF-së, gjykata e falimentimit vendos për përfundimin e procedurave të falimentimit për shkak të mungesës së pasurive nëse, si rezultat i hetimeve të kryera, prokurori vendos të mos fillojë procedurat^[70] ose të rrëzojë çështjen^[71]. Gjykata është gjithashtu e detyruar të përfundojë procedurën e falimentimit kur kanë kaluar 6 muaj nga transferimi i dosjeve tek prokurori për hapjen e hetimeve.

subjekt juridik i kontrolluar nga debitori, sipas legjisllacionit përkatës për shoqëritë tregtare; ii) çdo subjekt juridik i të njëjtit grup shoqërisht me debitorin; iii) drejtori i përgjithshëm, administratori ose secili nga anëtarët e bordit drejtues ose bordit mbikqyrës të debitorit; iv) çdo person që zotëron më shumë se një të katërtën e kapitalit të debitorit; v) çdo anëtar i debitorit me përgjegjësi të pakufizuar për detyrimet e debitorit; vi) çdo person që ka dijeni për informacion konfidencial ose të dhëna për gjendjen financiare të debitorit, për shkak të pozitës së veçantë me debitorin.

[70] Neni 290 i Kodit të Procedurës Penale parashikon që: Procedimi penal nuk fillon kur: a) personi ka vdekur; b) personi nuk ka asnjë përgjegjësi penale ose nuk ka arritur moshën e përgjegjësisë penale; c) ankesa e viktimës mungon ose ai/ajo e tërheq ankesën; d) akti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur vërtetohet qartë se akti nuk ekziston; e) vepra penale është zhdukur; f) është lëshuar një amnisti; g) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

[71] Neni 328 i Kodit të Procedurës Penale parashikon që: Pas përfundimit të hetimeve paraprake, kur procedohet kundër kundërvajtjeve penale, prokurori vendos të rrëzojë akuzën ose çështjen kur: a) është e qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimi nuk ka bërë një ankesë ose heq dorë nga ajo, në rastet kur procedurat fillojnë me kërkesën e saj; d) personi nuk mund të merret si i pandehur ose mund të mos dënohet; e) ekziston një arsye që shuan veprën penale ose për të cilën procedura penale nuk duhet të fillohet ose të vazhdohet; f) është provuar se i pandehuri nuk ka kryer shkelje ose nuk provohet se i pandehuri e ka kryer atë; g) i pandehuri është gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për të njëjtin veprim; h) i pandehuri vdes; i) në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Megjithëse gjykata e falimentimit mbyll procedurat në përfundim të 6 muajve, prokurori mund të ndjekë hetimin penal përtej kësaj periudhe. Ky proces do të jetë në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale. Në mënyrë të ngjashme, në rast se përcaktohet që veprimet e debitorit përbëjnë vepër penale, prokurori paraqet çështjen për gjykim.

Si përfundim, prokurorët duhet të kuptojnë se në rast të gjetjeve të reja gjatë hetimit penal, gjykata e falimentimit mund të jetë e interesuar të konsiderojë këto gjetje në kontekstin e rinisjes së procedurave të falimentimit. Sipas Nenet 154.1 *“Nëse, në çdo kohë brenda një viti pas përfundimit të procedurës së falimentimit, zbulohen pasuri të reja që i përkasin debitorit ose identifikohen pretendime të mundshme për shmangien e veprimit ose identifikohen përgjegjësitë e organeve drejtuese, çdo kreditor mund të kërkojë rifillimin e çështjes së falimentimit”*.

Disa veprime të kryera nga debitori mund të përbëjnë një vepër penale sipas parashikimeve të Kodit Penal Shqiptar, kështu që prokurori do të vazhdojë hetimet përtej rolit të prokurorit siç përcaktohet nga LF-ja. Në rast se veprimet e kryera nga debitori përbëjnë një vepër penale në fushën e falimentimit të parashikuar në Kodin Penal Shqiptar, Kapitulli III, Seksioni IX, nenet 193-196, prokurori mund të regjistrojë çështjen penale dhe të fillojë hetimin.

Dispozitat e mëposhtme në Kodin Penal përcaktojnë veprat penale në fushën e falimentimit:

- Neni 193 parashikon “Falimentimin e Provokuar”: *“Provokimi i qëllimshëm i falimentimit të një personi juridik dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”*.
- Neni 194 parashikon “Fshehjen e statusit të falimentimit”: *“Lidhja e një marrëdhënie ekonomike tregtare midis një personi juridik dhe një pale të tretë me qëllim fshehjen e një statusi falimentimi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet”*.
- Neni 195 parashikon “Fshehjen e pasurisë së falimentimit”: *“Fshehja e pasurive pas falimentimit të një personi juridik, me qëllim shmangien e pasojave të tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet”*.
- Neni 196 parashikon “Mosrespektimin e detyrimeve”: *“Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga falimentimi i personit juridik përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet”*.

Për ta përmbledhur, roli i prokurorit mund të shkojë përtej hetimeve të kryera sipas LF-së. Pas kalimit të gjetjeve (d.m.th. pretendimeve të palëve) nga gjykata drejt prokurorit sipas Nenet 20.3 të LF-së, ky i fundit, me anë të legjislacionit penal shqiptar ka juridiksionin për të ndjekur ose jo ndonjë hetim ose procedurë të mëtejshme penale përtej LF-së. Në fakt, sipas Kodit të Procedurës Penale, roli i prokurorit në një procedurë falimentimi nuk duhet të kufizohet vetëm në hetimin e veprimeve të kryera nga debitori, por mund të përfshijë edhe çdo palë tjetër të procedurave të falimentimit. Për më tepër, prokurori, përveç veprave penale që lidhen me falimentimin (të përshkruara në paragrafin e mësipërm) mund të hetojë edhe vepra të tjera penale të tilla si “Dëshmia e rreme” (Neni 306, Kodi Penal) ose “Ekspertimi i rremë” (Neni 28 i LF-së/Neni 309, Kodi Penal).

VI. KUPTIMI I PROCEDURAVE TË FALIMENTIMIT DHE KARAKTERISTIKAT E TYRE KRYESORE

VI.I. Faza e përbashkët

Një fazë e përbashkët pason vendimin për hapjen e një procedure falimentimi. Gjatë kësaj faze, është krijuar një kuadër për të parandaluar interesat individuale që pengojnë përpjekjet e bashkëpunimit të cilat, potencialisht çojnë në rezultate më të mira të përgjithshme. Funkcionimi i vazhdueshëm i aktivitetit të debitorit pas fillimit të procedurës së falimentimit është thelbësor për një riorganizim të suksesshëm. Vazhdimi i aktivitetit të debitorit të falimentimit kërkon vëmendje të veçantë për të nxitur një administrim efektiv, efikas dhe të drejtë të masës së falimentimit. Për këtë arsye, kreditorëve u jepen të drejtat e mëposhtme për administrimin e masës së falimentimit:

1. Të kërkojnë qasje në informacione mbi veprimtarinë e debitorit. E drejta për informacion është e rëndësishme pasi i lejon kreditorët të marrin vendime të informuara dhe të arsyetuara. Këto të drejta shtrihen në fazën e zbatimit të një plani riorganizimi të miratuar.
2. Ndërsa emërimi i një administratori i është caktuar gjykatës kompetente^[72], e cila përcakton edhe shpërblimin e tyre, kreditorëve u jepet gjithashtu një rol i rëndësishëm. Kreditorët jo vetëm që mund të ankimojnë vendimin e gjykatës së falimentimit për shpërblimin e administratorit, por gjithashtu mund të kërkojnë shkarkimin në rast se administratori nuk ka përmbushur detyrat e tij.^[73]
3. Të kenë të drejtën të zgjidhen si anëtarë të komitetit të kreditorëve^[74]. Komiteti i kreditorëve ka një rol kryesor në administrimin e masës së falimentimit pasi lejon mbikqyrjen më të afërt të administrimit të masës së falimentimit.^[75] Komiteti merr llogaritë nga administratori i falimentimit, kthen përgjigje dhe madje mund të kundërshtojë ndonjë prej llogarive të paraqitura.^[76] Komiteti i kreditorëve gjithashtu ngarkohet të japë një mendim në gjykatë përpara se të miratohen transaksione me rëndësi të veçantë.^[77]

Komiteti i kreditorëve, i përbërë nga jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 5 anëtarë, emërohet nga mbledhja e kreditorëve.^[78] Të gjithë anëtarët e komitetit kanë një

[72] Shikoni nenin 43 të LF-së.

[73] Shikoni nenin 45 të LF-së. Kreditorët duhet të mbajnë të paktën 10 përqind të shumës totale të kërkesave për ta bërë këtë.

[74] Shikoni nenin 50 të LF-së.

[75] Për të ushtruar siç duhet detyrat e tij, Komiteti i Kreditorëve mund të kontrollojë librat e debitorit dhe secili prej anëtarëve të tij ka të drejtë të marrë nga administratori i falimentimit informacion lidhur me aktivitetet e tij, përfshirë kërkesën për praninë e tij në mbledhjet e komitetit.

[76] Shikoni nenin 49 të LF-së.

[77] Shikoni nenin 85 të LF-së.

[78] Nëse është e mundur, Komiteti i Kreditorëve duhet të përfshijë një anëtar nga kreditorët e preferuar dhe një ose më shumë nga ata të pasiguruar dhe nuk duhet të ketë shumicën e kreditorëve të siguar. Kur debitori ka më

votë, pavarësisht nga vlera e pretendimeve të tyre. Mbledhjet e komitetit janë të vlefshme nëse shumica e anëtarëve të saj janë të pranishëm. Vendimet miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm.^[79]

4. T'i njoftojnë administratorit ekzistencën e një transaksioni që duhet të anulohet dhe të fillojë veprimet e kundërshtimit nëse administratori nuk arrin t'i fillojë ato brenda dy muajve nga marrja e njoftimit.^[80]
5. Të kërkojnë bashkërisht që administratori të thërrasë mbledhjen e kreditorëve. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet nga a) 5 ose më shumë kreditorë fundorë të falimentimit, të cilët zotërojnë bashkërisht të paktën një të pestën e vlerës totale të pretendimeve (duke përjashtuar ato fundore), ose b) 2 ose më shumë kreditorë që zotërojnë bashkërisht të paktën dy të pestat e vlerës totale të pretendimeve (duke përjashtuar ato të kreditorëve fundorë).

Një veprim i rëndësishëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e masës së falimentimit ka të bëjë me marrjen e masave të ndërmjetme për ruajtjen e masës së falimentimit. LF-ja përfshin një pezullim të procedurave duke detyruar çdokënd që pretendon se ka një pretendim përpara procedurës së falimentimit ndaj debitorit duhet ta paraqesë atë brenda procedurës së falimentimit në mënyrë që të njihet si kreditor i falimentimit (shikoni më poshtë). Pezullimi zbatohet për depozitimin e padive nga kreditorët dhe për çdo procedurë ekzekutimi, tashmë në proces ose që do të fillojë. Pezullimi gjithashtu përfshin kreditorët e siguruar në masën që kolaterali i tyre është i nevojshëm për biznesin ose veprimtarinë profesionale të debitorit. Pezullimi i fundit (ai që prek kreditorët e siguruar) zgjat vetëm për 6 muaj ose derisa të miratohet plani i riorganizimit, çfarëdo që të ndodhë e para. Ai që prek kreditorët e pasiguruar ndikon pretendimet gjatë kohëzgjatjes së të gjithë procesit. Prandaj, debitorët mbrohen nga çdo veprim i kreditorit jashtë procedurës së falimentimit

Vendimi për vazhdimin e procedurës

Një sistem i balancuar falimentimi lehtëson filtrimin e shoqërive të debitorit duke lejuar riorganizimin e shoqërive të shëndetshme dhe likuidimin e të tjerave. Ndërsa sisteme të ndryshme ligjore i qasen çështjes në mënyra të ndryshme, sistemi shqiptar me procedurë të përbashkët kërkon që vendimi nëse debitori duhet të shkojë drejt riorganizimit ose likuidimit të merret nga asambleja e raportimit të kreditorëve.

Pasi të merret një vendim nga gjykata për pranimin e pretendimeve të kreditorëve, LF-ja kërkon që një vendim të merret nga kreditorët, në një asamble raportuese, duke orientuar një debitor drejt riorganizimit ose likuidimit. Prandaj, 10 ditë përpara mbledhjes së kreditorëve, administratori duhet të paraqesë një raport i cili duhet të përbëjë bazën për diskutimet që do të zhvillohen në mbledhje. Asambleja e raportimit do të mblidhet nëse kreditorët që përfaqësojnë të paktën 50% të totalit të pretendimeve ose 35% në thirrjen e dytë, janë të pranishëm (ose të përfaqësuar rregullisht). Debitori si dhe palët e tjera të interesuara mund të japin komente për këtë raport në këtë mbledhje, që është një mundësi

shumë se 20 punonjës, një përfaqësues i punonjësve të tillë ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje (pa të drejtë vote).

[79] Shikoni nenin 51 të LF-së.

[80] Shikoni nenin 80 të LF-së.

e shkëlqyer për një debitor që të mbështesë çështjen për riorganizimin e tij. Për të filluar riorganizimin, shumica e vlerës së pretendimeve të pranishëm ose të përfaqësuara rregullisht në mbledhje duhet të votojnë në favor të saj.

VI.II. Faza e riorganizimit

Një pjesë thelbësore e çdo çështje falimentimi është një plan për riorganizimin e debitorit. LF-ja ofron një mundësi për debitorët të propozojnë një plan të riorganizimit si një mundësi e mirë për të mbajtur të hapur biznesin e tyre. Plani i riorganizimit përshkruan mënyrën e ripagimit të borxhit dhe operimet e biznesit do të vazhdojnë pasi plani të miratohet. Një plan riorganizimi mund të zbatohet nëse kreditorët e pranojnë atë dhe gjykata e konfirmon atë.

Faza e riorganizimit ka tre faza kryesore: a) propozimin e të paktën një plani riorganizimi, b) votimin për një plan ose plane të tillë, dhe c) zbatimin e një plani të miratuar.

Depozitimi i planit të riorganizimit

Planet e riorganizimit mund të paraqiten në gjykatë jo më vonë se një muaj pas mbledhjes së raportimit të kreditorëve nga debitori, administratori, nëse kërkohet nga kreditorët,^[81] dhe kreditorët që zotërojnë të paktën 20 përqind të pretendimeve të përgjithshme. Debitorët mund të paraqesin planin e tyre më herët gjatë procesit, madje së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit. Por ky fleksibilitet nuk duhet të ngatërrohet me rregulla të pazbatueshme: mosparaqitja e një plani të riorganizimit në kohën e duhur çon në procedura të likuidimit.^[82]

Planet janë përshtatur për të lejuar vendimin kolektiv dhe konsensual të falimentimit dhe mund të përfshijnë ristrukturimin operacional, si dhe riprogramimin financiar, duke filluar nga marrëveshjet e thjeshta për shlyerje të borxhit, deri te ristrukturimet komplekse të borxhit. Sipas LF-së, planet e riorganizimit duhet të ndjekin një seri rregullash. Këto rregulla synojnë të lehtësojnë miratimin e planit dhe të sigurojnë respektimin e përparësive të kreditorëve si më poshtë:^[83]

- a) shpjegimin e veprimtarisë së debitorit dhe vështirësitë financiare;
- b) një përshkrim të hollësishëm të masave të zbatimit të planit;
- c) një listë të hollësishme të kreditorëve të ndarë sipas klasave;
- d) detajet dhe vlera e pasurive dhe procedurat e përdorura për shlyerjen e borxheve të ndryshme;
- e) procedurat e shitjes, pasuritë që duhet të shiten dhe përdorimi i të ardhurave nga shitja;
- f) datën e fillimit dhe afatet e zbatimit të planit;

[81] Shikoni nenin 94 të LF-së.

[82] Shikoni nenin 104 të LF-së.

[83] Shikoni nenet 99 deri në 103 të LF-së.

- g) një deklaratë të qartë që plani përfundimtar zëvendëson çdo të drejtë konfliktuale që ekziston përpara;
- h) një listë të të gjithë anëtarëve të organit drejtues të debitorit dhe shpërblimin e tyre;
- i) të dhëna për financime të reja, dhe ristrukturimin dhe reformimin e borxheve;
- j) identifikimin e administratorit mbikqyrës të propozuar dhe detyrimet e tij për raportim;
- k) parashikimin financiar të situatës së debitorit gjatë periudhës së zbatimit të planit; dhe
- l) vlerësimin e fitimit të likuidimit si një alternativë.

Ndërsa ka liri të mjaftueshme për të hartuar dhe propozuar plane riorganizimi, debitorët duhet të mbajnë disa ide parasysh që do të ndihmojnë të marrin miratimin dhe të kufizojnë mundësinë që gjykata të refuzojë planin në rast se paraqitet një kundërshtim:

- Dorëzoni planin me mirëbesim.
- Planet e realizueshme kanë më shumë gjasa të tejkalojnë kundërshtimet.
- Kreditorët brenda një klase duhet të kenë trajtim të barabartë
- Kur kreditorët vendosen në pozitë më të mirë se sa do të ishin në rast të likuidimit, plani ka më shumë gjasa të miratohet.

Sapo të paraqitet plani i riorganizimit, gjykata e falimentimit menjëherë ia dërgon planin palëve të interesuara (përfshirë Komitetin e Kreditorit, nëse ka), për komente.

Sipas LF-së, planet e riorganizimit duhet të ndjekin një sërë rregullash. Këto rregulla synojnë të lehtësojnë miratimin e planit dhe të sigurojnë respektimin e prioriteteve të kreditorëve dhe këto rregulla përfshijnë:^[84]

- Planet e riorganizimit duhet të ndajnë kreditorët në klasa sipas rregullave të përparësisë që përfshihen në LF-në (shikoni më poshtë). Nën klasat janë të lejuara.
- Palët brenda secilës klasë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe çdo përjashtim nga ky rregull kërkon miratimin e klasave të prekura.
- Planin i riorganizimit nuk duhet të cenohet të drejtat e kreditorëve të siguruar; në të kundërt një miratim i veçantë kërkohet nga secili prej kreditorëve të siguruar.
- Të drejtat e kreditorëve fundorë do të konsiderohen si inekzistente nëse plani përfshin një zvogëlim të vlerës së pretendimeve të kreditorëve të preferuar ose kreditorëve të pasiguruar.
- Pretendimet fundore do të përmbushen vetëm nëse plani siguron shtyrjen e pagesës së plotë të pretendimeve të preferuara dhe të pasiguruara.

Pas depozitimit të planit të riorganizimit në gjykatën e falimentimit, kjo e fundit i'a paraqet menjëherë planin për komente palëve të interesuara (përfshirë Komitetin e Kreditorëve, nëse ka të tillë).

Votimi i Planit të Riorganizimit

Kreditorët e njohur rregullisht dhe ata që janë pjesë e listës së kreditorëve mund të marrin pjesë në mbledhjen e diskutimit dhe të votimit të planit.^[85] LF-ja kërkon të sigurohet një kuorum minimal nëse:

- kreditorët pjesëmarrës ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën 50% të shumës së përgjithshme të pretendimeve, ose
- kreditorët pjesëmarrës ose të përfaqësuar zotërojnë të paktën 50% të shumës së përgjithshme duke përjashtuar pretendimet e siguruara ose fundore.^[86]

Një avantazh i debitorëve që parashikohet në LF-në është që propozimi i tyre për planin e riorganizimit do të diskutohet dhe votohet në rend të parë. Nëse ky plan formon shumicën e kërkuar, asnjë plan tjetër nuk do të merret në konsideratë. Plani tjetër që do të merret në konsideratë është plani i hartuar nga administratori dhe më pas planet e paraqitura nga kreditorët, nëse ka.

Negociatat gjatë mbledhjes janë procese dinamike dhe mund të çojnë në ndryshime të planit. Nëse propozohen ndryshime thelbësore të planit, për shembull, një ndryshim që cenon vazhdimësinë e veprimtarisë tregtare ose një ndryshim që përfshin një zvogëlim të pretendimeve me më shumë se 5%, atëherë një mbledhje tjetër duhet të planifikohet brenda 15 ditëve të ardhshme për të votuar planin e ndryshuar. Një vonesë e tillë i jep kreditorëve mundësinë për të marrë në konsideratë në mënyrën e duhur ndikimin e këtyre ndryshimeve, ndërsa i jep debitorëve mundësi tjetër për negociata të mëtejshme.

Si rregull i përgjithshëm, një plan do të konsiderohet i miratuar nëse, në çdo klasë, shumica në vlerën e pretendimeve të kreditorëve të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje votojnë në favor të planit. Përjashtimisht, nëse plani parashikon zvogëlimin e më shumë se 50% të pretendimeve ose një riplanifikim të tyre për më shumë se pesë vjet, miratimi i planit është i vlefshëm nëse miratohet nga jo më pak se 65% të pretendimeve të klasës së prekur.^[87] Kreditorët e siguar votojnë vetëm në rast se ata janë të prekur nga plani.^[88] Pretendimet e kreditorëve fundorë, nga ana tjetër, konsiderohen të përjashtuara për qëllime të votimit, megjithëse plani mund të parashikojë një përjashtim nga ky rregull.^[89] Ndërsa për Debitorin, miratimi i tij do të prezumohet përveç nëse ai nuk e kundërshton planin deri në datën e mbledhjes së kreditorëve. Megjithatë, kundërshtimi i një debitori si person juridik do të konsiderohet i pavlefshëm nëse plani nuk e lë debitorin në një situatë më të keqe se ajo e likuidimit, dhe nëse asnjë kreditor nuk do të marrë vlerë më të madhe se ajo e pretendimit të tij.

Edhe kur një plan nuk përmbush asnjë nga kufijtë e miratimit të përmendura më lart, plani mund të miratohet nga debitori ose propozues të tjerë, një situatë që njihet zakonisht si ristrukturim i borxhit. Pra, nëse kreditorët e një klase të caktuar nuk e miratojnë planin, ky i fundit do të konsiderohet i miratuar nëse përmbushen tre kushte. Së pari, kreditorët e klasës në fjalë nuk janë në një situatë më të keqe sipas planit sesa do të ishin në rastin

[85] Shikoni nenin 105 të LF-së.

[86] Shikoni nenin 104 të LF-së.

[87] Shikoni nenin 108 të LF-së.

[88] Shikoni nenin 101 të LF-së.

[89] Shikoni nenin 103 të LF-së.

e likuidimit të debitorit. Së dyti, anëtarët e kësaj klase nuk duhet të diskriminohen në krahasim me anëtarët e çdo klase tjetër brenda të njëjtës nëndarje. Së fundi, LF-ja gjithashtu parashikon që asnjë anëtar i ndonjë klase tjetër nuk merr një kompensim më të lartë sesa shuma e pretendimeve të tij.^[90]

Kundërshtimi dhe ankimi kundër Planit të Riorganizimit

Pas pranimit të planit dhe depozitimit të procesverbalit të asamblesë në gjykatë, palët e interesuara mund t'i shqyrtojnë ato.^[91] Administratori, debitori, kreditorët që kanë votuar kundër planit dhe ata që nuk morën pjesë në mbledhjen e kreditorëve mund të depozitojnë një kundërshtim me shkrim të planit, të shoqëruar nga të gjitha dokumentet përkatëse dhe materialet argumentuese brenda dhjetë ditëve nga depozitimi në gjykatë. Plani i kundërshtimit mund të bazohet vetëm në:

- (i) një shkelje të dispozitave të LF-së në lidhje me përmbajtjen e planit,
- (ii) mungesën e shumicës së vlefshme,
- (iii) ndonjë shkelje të kërkesave procedurale formale të përcaktuara në LF-në për zhvillimin e asamblesë, për shembull, rregullat procedurale në lidhje me thirrjen e asamblesë, përfaqësimin e palëve, procedurën e votimit, llogaritjen e kuorumit dhe shumicës, dhe përcaktimin e klasave të kreditorëve, dhe
- (iv) mungesën e zbatueshmërisë së planit.

Pra, Gjykata do të vendosë për çdo kundërshtim ndaj miratimit të planit.^[92]

Debitorët, si dhe kreditorët që kanë kundërshtuar planin, mund të depozitojnë një ankim kundër miratimit të planit ose një kundërshtim brenda 10 ditëve nga data e vendimit të gjykatës për miratim. Ky ankim nuk pezullon zbatimin e planit të riorganizimit, përveç nëse gjykata e apelit vendos ndryshe, mbështetur në shkaqe që cenojnë rëndë interesat e kreditorëve ose interesat publikë.^[93]

Efektet dhe zbatimi i Planit të Riorganizimit

Miratimi i planit të riorganizimit do të ketë efektet e mëposhtme:

- Përmbajtja e planit është detyruese për të gjithë kreditorët e falimentimit, por nuk do të cenojë detyrimin e bashkëdebitorëve ose garantuesve.
- Debitori duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga plani, dhe jo detyrimet e mëparshme.
- Të gjitha kërkesat për ekzekutim që rrjedhin nga pretendimet përpara fillimit të

[90] Shikoni nenin 112 të LF-së.

[91] Pala përcaktohet në nenin 3 të LF-së për të përfshirë debitorin, çdo kreditor, administratorin ose ndonjë palë tjetër, e konsideruar kështu sipas LF-së.

[92] Nëse nuk paraqitet asnjë kundërshtim, plani konsiderohet i miratuar pa veprime të mëtejshme. Shikoni nenin 111 të LF-së.

[93] Shikoni nenin 114 të LF-së.

procedurës së falimentimit pezullohen gjatë kohëzgjatjes së planit, ose do të pushohen nëse parashikohet shprehimisht në plan.

- Debitori shkarkohet nga detyrimet e bashkëdebitorëve dhe garantuesve që pretendojnë kundrejt tij.
- Detyrat e administratorit konsiderohen që janë përmbushur.^[94] Megjithatë, një administrator mund të qëndrojë në detyrë, duke vepruar si një administrator i mbikqyrjes, nëse plani e parashikon shprehimisht këtë.
- Debitori rimerr të drejtën e disponimit të pasurisë së tij sipas kushteve të planit.

Nëse plani është zbatuar rregullisht, administratori njofton gjykatën duke paraqitur vërtetimin për përmbushjen e plotë dhe paraqet të gjitha dhe çdo dokument që vërtetojnë përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në plan. Gjykata më pas duhet të shprehet me vendim për përmbushjen e planit. Ky vendim duhet të shpallet publikisht.

Në rast se depozitohet një kundërshtim në lidhje me zbatimin e plotë të planit, administratori i mbikqyrjes duhet t'i paraqesë gjykatës shpjegimet e nevojshme dhe gjykata do të vendosë nëse do të miratojë përmbushjen e planit ose të fillojë procedurat e likuidimit.

VI.III. Riorganizimi i përshpejtuar sipas LF-së

LF-ja ofron gjithashtu një mundësi tërheqëse për debitorët që janë në një situatë të pashmangshme falimentimi që mund ti prekë ata brenda gjashtë muajve. Objektivi i kësaj procedure të përshpejtuar është të parandalojë vështirësitë financiare duke marrë miratimin për një plan riorganizimi nga të gjitha palët e interesuara. Ky opsion sigurohet kur debitori është ende në gjendje të përmbushë detyrimet e tij. LF-ja parashikon që debitori dhe kreditori mund të lidhin një marrëveshje të hartuar jashtë gjykatës, e cila duhet të miratohet nga Gjykata e Falimentimit.

Kërkesa e cila duhet të paraqitet brenda periudhës 6 mujore përpara fillimit të procedurës së parashikuar të falimentimit ndjek procedurën e kërkesës së rregullt të falimentimit, por përfshin elementë shtesë dhe i nënshtrohet afateve më të shkurtra për hapat e saj të ndryshme.

Përveç kërkesave të rregullta, debitori paraqet kërkesën duke përfshirë:

- a) të gjitha dokumentet e renditura në shkronjat "a" deri në "e", të pikës 1, të Nenit 14, të LF-së, përshtatur me situatën e pashmangshme të paaftësisë paguese; (një raport i debitorit që përmban shkaqet e falimentimit, pasqyrat financiare për tre vitet e fundit, një listë e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, fluksin e parave dhe burimet e të ardhurave, një listë e debitorëve dhe kreditorëve dhe një listë e të gjitha procedurave ligjore në të cilat debitori është palë);
- b) një propozim të planit të riorganizimit, duke përfshirë detyrimisht përmbajtjen e përshkruar në Nenin 98 të LF-së;
- c) deklaratë noteriale për gatishmërinë e mbështetjes së kreditorit/ëve, që përfaqësojnë 30 përqind ose më shumë të vlerës totale të pretendimeve të

[94] Shikoni nenin 117 të LF-së.

regjistruara në llogaritë e debitorit.

Gjykata do të hapë procedurën e përshpejtuar të riorganizimit nëse vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese të debitorit dhe kërkesa është në përputhje me kërkesat e mësipërme. Gjatë këtyre procedurave, debitori vazhdon të administrojë biznesin e tij por çdo transaksion që nuk përfshihet në rrjedhën normale të veprimtarinë së tij kërkon miratimin e administratorit. Ndërsa, procedurat e ekzekutimit kundër debitorit do të pezullohen me qëllim lehtësimin e negociatave.

Për të ndjekur zhvillimet, administratori do të hartojë një raport të ndërmjetëm mbi shkaqet e vështirësive financiare të debitorit, si dhe një raport përfundimtar mbi planin e riorganizimit të përshpejtuar të paktën një javë përpara votimit. Të dy raportet duhet të depozitohen menjëherë në gjykatë. Pas krijimit të një liste kreditorësh, duke ndjekur kryesisht procedurën e vendosur për procedurat e përgjithshme të falimentimit, kreditorët do të votojnë mbi propozimin e riorganizimit të përshpejtuar. Kuorumi dhe miratimet rregullohen nga rregullat që zbatohen në procesin e përgjithshëm të riorganizimit. Kundërshtimet, nga ana tjetër, lejohen vetëm në bazë të mosarritjes së shumicave të kërkuara.

Pas miratimit, plani i riorganizimit të përshpejtuar do të zbatohet me kusht që debitori të vazhdojë të administrojë biznesin e tij gjatë zbatimit. Nëse plani refuzohet, atëherë gjykata e falimentimit do të shpallë hapjen e procedurës së zakonshme të falimentimit, përveç rasteve kur debitori vërteton që nuk është në gjendjen e paaftësisë paguese.

VI.IV. Faza e Likuidimit

Debitorët jo të shëndetshëm ekonomikisht kërkojnë një procedurë që lejon shlyerjen e kreditorëve, si dhe një rishpërndarje të shpejtë të pasurive për një përdorim më efikas. Procedurat e likuidimit janë zgjidhja zyrtare e parashikuar në LF-në për të trajtuar situata të tilla.

Fillimi i Procedurave

Gjykata e falimentimit vendos për fillimin e likuidimit në rastet e mëposhtme:

- i. *Me kërkesë të debitorit:* Likudimi mund të kërkohej nga debitori, në çdo kohë gjatë procedurës së falimentimit ose menjëherë pasi debitori vëren se plani i riorganizimit nuk mund të zbatohet.^[95] Në secilin rast, administratori i falimentimit ose ai mbikqyrës do të jap mendimin e tij në gjykatën e falimentimit në lidhje me këtë kërkesë të debitorit, përpara se kjo gjykatë të marrë vendimin për kërkesën e debitorit.
- i. *Me kërkesë të administratorit:* Administratori i falimentimit ose ai i mbikqyrjes mund të kërkojë likuidimin, në rast se aktiviteti tregtar i debitorit është pezulluar ose debitori nuk e zbaton planin. Debitori ka të drejtë të dëgjohet përpara se gjykata të marrë një vendim.

[95] Shikoni nenin 135 të LF-së.

- i. *Gjithashtu, kreditorët mund të vendosin në favor të likuidimit në mbledhjen e raportimit.*^[96]

Pasojat e Likuidimit

- Debitori do të humbasë të drejtën për administrimin dhe disponimin e pasurisë së tij.
- Të gjitha borxhet do të konsiderohen të maturuara.
- Plani i likuidimit hartohet nga administratori dhe do të rishikohet nga të gjitha palët e interesuara. Në masën e lejuar, plani i likuidimit duhet të parashikojë transferimin e biznesit të debitorit që të vazhdojë të operojë. Debitori, si dhe kreditorët dhe punëmarrësit e tij, mund të paraqesin komente ose kundërshtime brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të planit në gjykatë. Duke marrë parasysh komentet e tyre, administratori i falimentimit mund të riformulojë planin tërësisht ose pjesërisht brenda 5 ditëve;
- Pas miratimit nga gjykata, plani i likuidimit duhet të zbatohet brenda tre muajve, por afati mund të zgjatet në mënyrë të arsyeshme deri në gjashtë muaj;
- Administratori duhet të depozitojë një raport çdo dy muaj;
- Në përputhje me planin e likuidimit, masa e falimentimit do të likuidohet dhe shpërndarja e të ardhurave do të bëhet tek kreditorët e listuar në përputhje me radhën e përparësisë në Nenin 144 si më poshtë:
- Debitorët si persona juridikë pushojnë së ekzistuari;
- Debitorët si persona fizikë shpesh shkarkohen nga borxhet (shikoni diskutimin në vijim);

Shembull: *Adnani arriti të negociojë me 5 kreditorët e tij një plan riorganizimi të përshtetshëm pasi ai vlerësoi se do të bëhej i paaftë për të paguar brenda 3 muajve. Plani nuk ishte i mirëmbledhur dhe Adnani e kuptoi që plani nuk mund të zbatohet për shkak të rënies me 70% të të ardhurave të tij të pritshme.*

Rezultati: *Adnani mund të paraqesë një kërkesë për procedurën e falimentimit në gjykatë dhe të kërkojë likuidimin e menjëhershëm.*

- Në fund të procesit të likuidimit, procedurat e falimentimit zakonisht përfundojnë.^[97]

Plani i Likuidimit

Administratori i falimentimit harton planin e likuidimit dhe e depoziton atë në gjykatë brenda 20 ditëve nga data e vendimit të likuidimit.^[98] Plani i likuidimit që parashikon

[96] Shikoni nenin 93 të LF-së.

[97] Duhet të theksohet se për një vit të plotë pas përfundimit të procedurave, debitorët mund të monitorohen dhe nëse shfaqen pasuri të fshehura, procedurat mund të rifillojnë. Kjo do të ndodhë nëse pasuritë mund të mbulojnë koston e rifillimit të procedurave plus 5% të detyrimeve të papaguara.

[98] Shikoni nenin 138 të LF-së.

mënyrën e likuidimit të pasurive që përfshihen në masën e falimentimit, duhet t'i vendoset në dispozicion për shqyrtim në gjykatë. Debitori, si dhe kreditorët dhe punëmarrësit e tij, mund të paraqesin komente ose kundërshtime brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të planit në gjykatë. Duke marrë parasysh komentet e tyre, administratori i falimentimit mund të riformulojë planin tërësisht ose pjesërisht brenda 5 ditëve.

Gjykata e falimentimit vendos për përmbajtjen përfundimtare të planit të likuidimit brenda 5 ditëve pas dorëzimit të planit. Pas miratimit, administratori i falimentimit vë në zbatim planin e likuidimit në përputhje me parashikimet e LF-së, brenda tre muajve nga data e fillimit të procedurave të likuidimit.^[99] Afati mund të shtyhet edhe me tre muaj te tjerë me kërkesë të administratorit. Gjatë zbatimit të planit të likuidimit, administratori i falimentimit duhet të përgatisë një raport të detajuar të ecurisë çdo dy muaj. Kreditorët kanë të drejtë të kenë akses në çdo raport të ecurisë.

Radha e përparësive dhe Shpërndarja te Kreditorët

Pas shitjes së pasurive, pretendimet e kreditorëve janë përmbushur sipas radhës së përparësive të përcaktuar në LF-në. Përmbushjet e pretendimeve të kreditorëve janë objektivi i deklaruar i LF-së, pavarësisht nëse përfundimi i një procedure çon në riorganizim ose likuidim. Në fund të ditës, procedurat e falimentimit janë përcaktuar për të arritur një rezultat më të mirë të përbashkët për kreditorët sesa në rastin kur ata do të përpiqeshin të mblidhnin detyrimet individualisht. Për këtë arsye, kanalizimi i burimeve drejt kreditorëve mbetet një funksion kryesor i procedurës së falimentimit.

Shlyerja e kreditorëve në një procedurë falimentimi varet nga pretendimet e tyre të njohura kundër debitorit i cili ndodhet në gjendjen e paaftësisë pague, ^[100] të drejtat përkatëse të kreditorëve sipas radhës së përparësisë të LF-së dhe shumës që do t'i paguhet kreditorëve. Radha e përparësisë për shpërndarjen te kreditorët e falimentimit përcaktohet në mënyrë hirearkike dhe është diskutuar në seksionin IV: ^[101]

Struktura hierarkike e përshkruar më sipër është përforcuar nga një rregull që përcakton se asnjë pagesë e pretendimeve të kreditorëve të një radhe përparësie më të ulët nuk mund të kryhet përveç nëse janë shlyer plotësisht të gjitha pretendimet e kreditorëve të një radhe me përparësi më të lartë. Gjithashtu, kur burimet janë të pamjaftueshme për të përmbushur plotësisht të gjitha pretendimet e një nënndarje, këto pretendime do të shlyhen në mënyrë proporcionale. ^[102] Nga ana tjetër, pretendimet e kreditorëve të procedurës, nuk bazohen në këto parime (shikoni seksionin IV). ^[103]

[99] Shikoni nenin 140 të LF-së. Kjo mund të përfshijë shitjen e pasurive të siguruar. Shikoni nenin 141 të LF-së.

[100] Shikoni Pjesën Katër, kapitulli II i LF-së.

[101] Shikoni nenin 144 të LF-së.

[102] Një paralajmërim i rëndësishëm për këtë rregull vjen nga rregullat për kredinë e siguruar. Midis tyre, pengjet dhe hipotekat tipike kanë një renditje përparësie që i përgjigjet sekuencës në të cilën ato ishin regjistruar. Ky rregull shpesh njihet si i pari në kohë, i pari në të djathtë. Prandaj, një hipotekë e shkallës së parë në një aktiv do të duhet të shlyhet plotësisht përpara se të paguhet ndonjë gjë për hipotekën e shkallës së dytë.

[103] Shikoni nenin 144 të LF-së. Nëse një detyrim tatimor është ngritur si pasojë e procedurave të falimentimit, autoriteti tatimor do të konsiderohet si kreditor i procedurës së falimentimit dhe pretendimi i tij do të paguhet kur të jetë për t'u paguar.

VI.IV.I. Shkarkimi i debitorit nga detyrimet–Rifillimi

Likuidimi i pasurive të debitorit është mënyra kryesore e shlyerjes nga debitori. Debitori person fizik mund të shkarkohet nga detyrimet e mbetura që nuk janë shlyer gjatë procedurave. Kërkesa për shkarkimin nga detyrimet e mbetura duhet të shoqërohet nga një deklaratë që vërteton vullnetin e debitorit për t'i transferuar çdo shumë përtej limiteve të kostos së jetesës Kujdestarit që do të caktohet nga gjykata e falimentimit, siç është propozuar nga debitori. Kujdestari do të caktohet për një periudhë 5 vjeçare, ose një periudhë tjetër që do të vendoset nga gjykata, për të shpërndarë shumat mbi baza vjetore te kreditorët e falimentimit, pretendimet e të cilëve nuk janë shlyer plotësisht përmes likuidimit. Shuma e dorëzuar nga debitori, që është çdo shumë përtej limiteve të kostos së jetesës, do të jetë zgjidhja për lehtësimin e shlyerjes së mëtejshme nga kujdestari. Gjatë këtij procesi, debitori duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- a) të kryejë veprimtari të përshtatshme me qëllime fitimi ose të kërkojë të punësohet dhe nëse, është i papunë, të mos refuzojë një punësim të arsyeshëm,
- b) t'i transferojë kujdestarit gjysmën e vlerës së pasurisë e fituar nga ai me anë të trashëgimisë ose në lidhje me të drejtat e ardhshme që rrjedhin nga trashëgimia;
- c) të njoftojë administratorin për vendbanimin e ri ose vendin e ri të punës,
- d) të informojë gjykatën ose kujdestarin për çdo të ardhur nga punësimi dhe përpjekjet e bëra për të gjetur punë;

Debitorët duhet të kenë parasysh se disa borxhe nuk do të shkarkohen, dhe debitori do të jetë i detyruar ti paguajë ato. Borxhet që nuk do të shkarkohen përfshijnë

- *huatë që i janë dhënë debitorit për të paguar shpenzimet e procedurës së falimentimit;*
 - *detyrimet që kanë lindur si rezultat i mashtrimit, dëshmive të rreme ose të veprimeve të tjera në keqbesim;*
 - *detyrimet në lidhje me mbështetjen financiare të fëmijëve; gjobat dhe sanksionet administrative; huatë e studentit;*
 - *detyrimet që rrjedhin nga veprimet që kanë shkaktuar dëmtimin e një personi tjetër nga debitori;*
 - *detyrimet që mbeten të pashkarkueshme nga procedura e mëparshme e falimentimit; dhe,*
 - *detyrimet në lidhje me pronat e transferuara te personat e lidhur me debitorin.*
- e) të kryejë pagesat për kreditorët e falimentimit vetëm nëpërmjet kujdestarit.

Duke iu nënshtruar kushteve dhe kufizimeve të mësipërme, debitori ia doli! Nuk ka më thirrje telefonike nga kreditorët, nuk ka më shkresa nga kreditorët dhe nuk ekziston më rreziku për t'u paditur për borxhe. Megjithatë, debitori duhet të ketë kujdes pasi revokimi i shkarkimit mund të ndodhë në ndonjë nga rastet e mëposhtme:

- për shkak të shkeljes të detyrimeve të debitorit duke penguar përmbushjen e detyrimeve të kreditorëve. Kjo gjykatë vendos që revokimet do të bëhen me kërkesë

të një kreditori falimentimi. Kjo mund të ndodhë në çdo kohë brenda 6 vjetësh nga vendimi për shkarkimin;

- nëse debitori nuk arrin të informojë gjykatën në lidhje me detyrimet e tij ndaj kreditorit;
- nëse evidentohet se debitori ka shkelur qëllimisht ndonjë nga detyrimet e tij dhe, si pasojë, ka dëmtuar në mënyrë të konsiderueshme kreditorët e falimentimit;
- nëse debitori është dënuar për vepër penale pas fillimit të procedurave të falimentimit dhe derisa kujdestari të mbyll veprimtarinë e tij;
- nëse shkarkimi është marrë me anë të mashtrimit; ose nëse kujdestari nuk merr shpërblimin e tij.

Në dallim nga personat juridikë, debitorët si persona fizikë nuk pushojnë së ekzistuari pas likuidimit. Shkarkimi nga detyrimet pas falimentimit do të lehtësojë debitorin si person fizik nga detyrimet e tij të mbetura dhe do ta lejojë atë të ketë një fillim të ri në aspektin ekonomik. Për të patur të drejtën e shkarkimit, debitori si person fizik duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e parashikuara në ligj.

VI.V. **Mbyllja e procedurave të falimentimit dhe afati kohor i veprimeve të kërkuara**

Pasi ka përfunduar shpërndarja përfundimtare, gjykata e falimentimit vendos për përfundimin e procedurës së falimentimit. Pagesa e plotë për të gjithë kreditorët e falimentimit, pavarësisht nga faza e procedurës, është gjithashtu një shkak për përfundimin e procedurës. Vendimi i gjykatës dhe arsyet e përfundimit shpallen publikisht.

VII. SHPJEGIME PËR MËNYRËN SE SI LIGJET E TJERA NDËRVEPROJNË ME LF-në

Pas rishikimit të procedurave të përcaktuara në LF, ky Seksion do të tregojë se si LF-ja dhe procedurat e përcaktuara në të, ndikohen nga pjesët e tjera të legjislacionit shqiptar. Këto ligje përmbajnë kërkesa që mund të pengojnë zbatimin e procedurave të falimentimit dhe për të kuptuar dhe ofruar një shpjegim më të saktë, ligjet janë ndarë në dy grupe kryesore:

- **Ligjet në lidhje me regjimet e përgjithshme të falimentimit:** rregullat e përgjithshme të falimentimit të parashikuara nga LF-ja dhe ndërlidhja e tyre me pjesët kryesore të legjislacionit siç janë Ligji për Shoqëritë Tregtare, Kodi Civil, Kodi i Procedurave Civile, Legjislacioni Tatimor, Ligji për Barrët Siguruese etj.
- **Ligjet që parashikojnë përjashtime nga regjimi i përgjithshëm i falimentimit, siç përcaktohet në pikën 4 të nenit 7 të LF-së:** regjime në të cilat dispozitat që rregullojnë falimentimin nuk rregullohen nga LF-ja por nga ligje të veçanta ose akte legjislative. Zakonisht përjashtime të tilla zbatohen për subjektet e industrisë bankare dhe tregjet financiare jo-bankare.

VII.I. Ligjet në lidhje me regjimet e përgjithshme të falimentimit

VII.I.I. Ligji për Shoqëritë Tregtare

Pjesa kryesore e legjislacionit e ndërthurur me LF-në është ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”). Parimet ligjore dhe përkufizimet e të dy ligjeve janë thelbësore për interpretimin e njëri-tjetrit pasi konceptet kryesore të tilla si shoqëria, personi fizik, sipërmarrësi, etj., të paraqitura në LF duhet të interpretohen në përputhje me përkufizimet që iu janë dhënë në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 2 i LF-së parashikon se: *“Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave”*. Ne vëmë re dy koncepte themelore në këtë dispozitë: a) shlyerjen e detyrimeve të debitorit; dhe b) zbatimin e parimit të pasurive në falimentim si një element thelbësor i procedurës së falimentimit. Pas këtij arsyetimi, duhet t’i jepet rëndësi leximit dhe interpretimit të Neneve 2 dhe 3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe Neneve 3.6 dhe 7 të LF-së.

- Pikat 1, 4, 6, 7 të Nenit 2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare parashikojnë se: *Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm..... Tregtari, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtari e tij, përgjigjet personalisht me të gjitha pasuritë dhe të drejtat e tij të tanishme dhe të ardhshme.....Tregtari e humbet statusin e tij kur pushon ushtrimin e veprimtarisë ose kur është i detyruar ta pushojë atë. Në një*

rast të tillë, ai çregjistrohet nga regjistri, në përputhje me Nenet 48 deri në 53 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Për më tepër, pikat 1 dhe 3 të Nenit 3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare parashikojnë që një Shoqëri do të përgjigjet me të gjitha pasuritë e saj për detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e saj.

- Pika 6 e Nenit 3 të LF-së përcakton debitorin si një person fizik ose juridik që paraqet ose kundër të cilit është paraqitur një kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit.

Neni 7 i LF-së parashikon se "1. Procedura e falimentimit mund të fillojë ndaj çdo debitori si person fizik ose juridik. 2. Procedura e falimentimit mund të fillojë edhe pas prishjes së personit juridik që ende nuk është likuiduar. 3. Procedura e falimentimit nuk mund të fillojë ndaj subjekteve publike, objekt i së drejtës administrative. Shoqëritë me kapital publik ose shtetëror, të organizuara si person juridik privat, janë objekt i këtij ligji."

Ajo që mund të vihet re nga këto dispozita është që si personat fizikë dhe personat juridikë i nënshtrohen procedurave të falimentimit në përputhje me LF-në. Megjithatë, ne mendojmë se LF-ja përmban një terminologji të dyfishtë dhe të ngjashme për personat fizikë (personat fizikë, siç përcaktohet në Nenet 3 (pika 6) dhe 7, dhe individët siç përdoret në Nenin 35 dhe Pjesa VII e LF-së) që nuk duhet të shpërqendrojnë praktikantët ligjor. Konfuzioni është kryesisht gjuhësor që rrjedh nga leximi i ligjit në gjuhën shqipe, meqenëse LF-ja përdor një terminologji të dyfishtë për individët duke iu referuar atyre si persona fizikë dhe individë. Në një kontekst të tillë, kur iu referohemi tregtarëve, ligji për shoqëritë tregtare përdor termin person fizik, e cila është pikërisht ajo që krijon konfuzion në lidhje me terminologjinë e dyfishtë të përdorur në LF, nëse lexohet në gjuhën shqipe. Nëse ligjet lexohen në gjuhën angleze, ky konfuzion nuk ekziston duke marrë parasysh dallimin e qartë të terminologjisë midis personave fizikë dhe juridikë.

Ajo që mund të sqarohet, ndoshta nëpërmjet interpretimit gjyqësor është se, përveç terminologjisë së dyfishtë të përdorur nga LF-ja, kjo e fundit mbulon si individët ashtu edhe personat fizikë, si debitorë në një procedurë falimentimi dhe padyshim që parashikon falimentimin e individëve. Kjo bëhet më e qartë nëse i referohemi procedurave të hollësishme në Pjesën VII, sipas të cilave individët mund të deklarohen të paafte për të paguar dhe si të tillë të përfshihen në procedurat e falimentimit. Si pasojë, ndërsa është e qartë se synimi i LF-së është që të lejojë edhe falimentimin e individëve, përdorimi i dyfishtë i termave krijon perceptimin e gabuar të një kuptimi të njëjtë me Nenet 2 dhe 3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Ligji për Shoqëritë Tregtare rregullon gjithashtu procedurën e likuidimit dhe prishjes së shoqërive. Prandaj është e rëndësishme të sigurohet që të mos lindë ndonjë keqkuptim ose abuzim për shkak të përdorimit të termit në dy mënyra të ndryshme. Kur një debitor paraqet një kërkesë për "likuidim" sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe më pas ka një kërkesë për fillimin e procedurave të falimentimit sipas LF-së, procedura e falimentimit duhet të pezullojë automatikisht procedurat e filluara sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare^[104]. Kjo mbështetet gjithashtu nga Kodi Civil i cili parashikon në paragrafin 2 të Nenit 38 që likuidimi i një personi të paafte për të paguar rregullohet nga një ligj specifik.

VII.I.II. Legjislacioni tatimor

Siç përmendet në pjesën hyrëse të këtij Komentari, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është përdorur për të përcaktuar, ndër të tjera, që administrata tatimore kishte të drejtë të kërkonte para gjykatës, fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit, shoqëritë tregtare që deklarorin një rezultat me humbje në lidhje me kapitalin e tyre për të paktën 3 vjet rresht. LF-ja e reformoi këtë qasje duke i'a hequr këtë kompetencë ekskluzive autoriteteve tatimore. LF-ja deklaroi se procedurat e përfshira në të qëndrojnë më lart krahasuar me procedurat e tjera të lidhura me falimentimin të parashikuara nga ligjet e tjera. Më saktësisht, LF-ja parashikoi që me hyrjen e tij në fuqi, Neni 104 i ligjit të procedurave tatimore duhet të shfuqizohet. Për të përmbushur këtë kërkesë të LF-së, Neni 104 i ligjit të procedurave tatimore u shfuqizua në nëntor 2016. Si pasojë, autoritetet tatimore nuk kanë më ndonjë detyrim specifik për të kërkuar hapjen e procedurave dhe ata duhet të ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura si kreditorët e tjerë.

VII.I.III. Kodi i Procedurave Civile

Ekziston një rregull edhe në Kodin e Procedurave Civile (Neni 323) dhe LF-në (Neni 4) sipas të cilit dispozitat e Kodit të Procedurave Civile (“KPC”) zbatohen për çështjet e falimentimit, vetëm në masën që ato nuk rregullohen nga LF-ja. Në rastet që LF-ja rregullon një çështje specifike, ajo mbizotëron mbi KPC-në. Sipas LF-së (Neni 16), falimentimi supozohet nëse kreditori nuk ka arritur të përmbushë një detyrim në një procedurë të detyrueshme përmbarimi gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar (siç parashikohet nga Neni 517 i Kodit të Procedurës Civile).

Pika të ndërveprimit ndërmjet zbatimit kolektiv dhe atij individual.

Neni 137 i LF-së përcakton që në rast të likuidimit me pjesë, shitja e pasurive kryhet me ankand, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile. Si pasojë, përveç kolateralit financiar (i cili zbatohet drejtpërdrejt nga mbajtësi i kolateralit siç shpjegohet në paragrafin VI.1.5 më poshtë), të gjitha pasuritë e siguruara duhet të nxirren në ankand përmes përmbaruesit (publik ose privat, sipas zgjedhjes së kreditorit) me anë të ankandeve publike siç parashikohet në Nenet 554 etj. të KPC-së.^[105]

Për sa i përket afateve procedurale, afatet kohore të parashikuara nga LF-ja do të kenë gjithmonë përparësi ndaj afateve të përgjithshme procedurale të përcaktuara në KPC. Kur rregullat e procedurave të parashikuara në KPC-në nuk bien në kundërshtim, por përkundrazi plotësojnë LF-në, Gjykatat kanë treguar se mbështeten gjithashtu në këto rregulla të KPC-së.

[105] Si një përjashtim nga ky rregull, neni 141 i LF-së parashikon që administratori i falimentimit sipas gjykimit të tij mund të vendosë nëse do të përjashtojë ose jo pasurinë e siguruar nga procedura e falimentimit nëse vlera e saj nuk mbulon vlerën e siguruar të pretendimit dhe shpenzimet për zbatimin e saj. Formulimi i kësaj dispozite sugjeron që administratori i falimentimit ka të drejtë të mbajë pasurinë në dobi të kreditorëve të falimentimit në rast se vlera e një pasurie është më e lartë se kërkesa e siguruar, duke parandaluar gjithashtu edhe kreditorin e siguruar të ushtrojë të drejtën për të ndarë kolateralin përkatës nga pjesa tjetër e pasurive të falimentimit.

Një rast tipik kur rregullat e KPC-së plotësojnë LF-në është ai i Neni 175 të KPC-së ku parashikohet se: *“Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancën përgatitore dhe përveç kësaj rezulton se ai është në dijeni të rregullt të asaj, gjykata vendos të pushojë çështjen. E njëjta gjë vlen edhe kur i padituri nuk ka paraqitur prapësimet (argumente mbështetëse të pretendimit). Në këto raste, Gjykata ka të drejtë të pushojë çështjet pa hyrë në themelin e çështjes së falimentimit”*.

VII.I.IV. Ligji për sistemin e pagesave

Kolaterali financiar ose “Kompensimi” (“*close-out netting*”) në procedurat e falimentimit rregullohen edhe nga LF-ja dhe Ligji 133/2013 “Për Sistemin e Pagesave”. Sipas përkufizimit të dhënë në ligj^[106], kolaterali financiar është *cash-i* dhe instrumentet financiare vendase ose të huaja dhe tituj të tjerë të ngjashëm me aksionet, obligacionet dhe format e tjera të instrumenteve të borxhit, nëse këto janë të negociueshme në tregun e kapitalit, tituj të tjerë të cilët normalisht tregtohen dhe që japin të drejtën për të tregtuar aksione, detyrime ose tituj të tjerë nëpërmjet anëtarësimi, blerjes apo këmbimit, ose që japin mundësinë e shlyerjes në para (me përjashtim të instrumenteve të pagesës), duke përfshirë kuotat në shoqëritë e investimeve kolektive, instrumente të tregut të parasë, metale të çmuara të kredituara në një llogari, si dhe pretendime që kanë lidhje me/ose të drejta që rrjedhin nga elementët e sipërcituara.

Me fillimin e procedurave të falimentimit, palët e tjera kërkojnë “Dispozitën e kompensimit” (“*close-out*”) për pozicionet e hapura dhe “shlyerjen” e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat financiare me debitorin. Kompensimi (“*Close-out netting*”) përfshin dy hapa: së pari, zgjidhjen e të gjitha kontratave të hapura si rezultat i fillimit të procedurave të falimentimit (*close-out*); së dyti, shlyerjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga transaksionet e mbyllura në bazë të agregatit (kompensimi “*netting*”). Lejimi i kompensimit “*Close-out netting*” pas fillimit të procedurave të falimentimit është një faktor i rëndësishëm në zbutjen e rreziqeve sistemike që mund të kërcënojnë stabilitetin e tregjeve financiare. Vlera ose ekspozimi sipas një kontrate financiare mund të ndryshojë ndjeshëm nga dita në ditë (dhe nganjëherë nga ora në orë) në varësi të kushteve në tregjet financiare. Prandaj, vlera e këtyre kontratave mund të jetë shumë e paqëndrueshme. Palët e tjera në mënyrë tipike zbutin ose mbrojnë rreziqet që lidhen me këto kontrata duke lidhur një ose më shumë kontrata “future” ose “shkëmbimi” me palë të treta, vlera e të cilave luhatet anasjelltas me vlerën e kontratës së debitorit^[107].

Në parim, kolaterali financiar mund të ekzekutohet pavarësisht fillimit ose vazhdimi të procedurave të falimentimit ose riorganizimit në lidhje me siguresin e kolateralit ose marrësit e kolateralit (Neni 26, shkronja “a” dhe Neni 28, pika 1 e ligjit të sistemeve të pagesave). Në një kontekst të ngjashëm, LF-ja përcakton që kreditorët e siguruar kanë të drejtë të zbatojnë të drejtat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për transaksionet e siguruara, jashtë procedurave të falimentimit, por në çdo rast u nënshtrohen kufizimeve të parashikuara nga LF-ja. Sipas Neni 141 të LF-së, një kreditor i siguruar ka të drejtë të kërkojë ndarjen e kolateralit të tij nga pjesa tjetër e pasurive të falimentimit, nëse vlera

[106] Neni 5, pikat e) dhe f) i ligjit 133/2013 “Për Sistemin e Pagesave”.

[107] Udhëzuesi Legjislativ i UNCITRAL për Ligjin e Falimentimit - Faqja 156, seksioni “H. Kontratat financiare dhe kompensimi “*netting*”

e kolateralit është më e lartë se shuma që i detyrohet kreditorit të siguar. Kreditorët kanë të drejtë të shesin ose disponojnë kolateralin e tyre sipas gjykimit të tyre, në varësi të miratimit të administratorit të falimentimit. Administratori i falimentimit mund të parandalojë kreditorin e siguar të ushtrojë një të drejtë të tillë nëse ai, për shembull beson se vlera e pasurisë mund të ndryshojë në të ardhmen. Si pasojë, kreditorët e siguar nëse lejohen nga administratori i falimentimit do të kishin të drejtë të zbatonin të drejtat e tyre jashtë procedurës së falimentimit vetëm kur vlera e kolateralit është e barabartë ose më e vogël në krahasim me vlerën e pretendimit të paraqitur nga kreditori i siguar. Nëse administratori vendos të mbajë kolateralin brenda masës së falimentimit, kreditorët e siguar do t'i nënshtrohen radhës së preferimit të përcaktuar në LF-në.

Siç tregohet në Nenin 26, shkronja “a” dhe Nenin 28, pika 1 e ligjit të sistemeve të pagesave, marrëveshjet e kolateralit financiar përbëjnë një përjashtim nga procedurat normale të falimentimit lidhur me ekzekutimin e kolateralit. Megjithatë, ky përjashtim nuk parashikohet shprehimisht nga LF-ja, duke krijuar kështu një papajtueshmëri ligjore midis dy pjesëve shumë të rëndësishme të legjislacionit. Meqenëse LF-ja nuk parashikon të drejtat e marrësve të kolateralit financiar që rregullohen nga dispozitat e kompensimit (“*close-out netting provisions*”) (me përjashtim të shlyerjes së llogarive të cilat në disa çështje mund të përfshihen në Nenin 71 të LF-së), krijohet konflikt kompetencash midis: (a) administratorit të falimentimit, i cili mbledh pretendimet e kreditorëve dhe shpërndan dhe/ose ndan pasuritë nga masa e tyre falimentimit, dhe (b) marrësit të kolateralit financiar, i cili shet kolateralin pa ndërhyrjen e ndonjë autoriteti, përfshirë administratorin e falimentimit.

Parimet e Bankës Botërore për Regjimet Efektive të Falimentimit dhe të Kreditorëve/Debitorëve përcaktojnë se zbatimi i dispozitave të zgjidhjes, të kompensimit në kontratat financiare duhet të lejohet, mundësisht sipas një moratoriumi afatshkurtër, ku mund të krijohen rreziqet e stabilitetit financiar.^[108]

VII.II. Përjashtimet nga regjimi i përgjithshëm i falimentimit

Në rastet e regjimeve të falimentimit të tregjeve financiare, duhet të deklarohet së pari se LF-ja nuk zbatohet në rastet e paaftësisë paguese të shoqërive të sigurimeve, bankave, fondeve të pensionit, fondeve të investimeve të letrave me vlerë dhe institucioneve të tjera që mbledhin depozita nga publiku ose institucione të tjera financiare, për të cilat procedura e falimentimit rregullohet me anë të një ligji specifik (pika 4 e Nenit 7 të LF-së). Megjithatë, LF-ja zbatohet për institucionet financiare jo-bankare, siç përcaktohet nga ligji shqiptar i bankave.

Ndërsa LF-ja përjashton shprehimisht shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve nga objekti i ligjit, vetë ligji nr. 52/2014 “Për sigurimet dhe risigurimet” (“**ligji i sigurimeve**”) duket se nuk pajtohet plotësisht me këtë rregull të përgjithshëm. Neni 182 i ligjit të sigurimeve parashikon se përveç dispozitave të falimentimit të këtij ligji, falimentimi i shoqërive të

[108] Parimet e Bankës Botërore për Regjimet Efektive të Falimentimit dhe të Kreditorëve/Debitorëve, 2015: Shih C10.4 dhe shënimin 9 për këtë parim. Dispozitat përkatëse të ligjit kombëtar duhet të rishikohen përgjithësisht për përputhshmëri me instrumentet ekzistuese ndërkombëtare, duke përfshirë në mënyrë specifike Direktivën e Rikuperimit dhe Zgjidhjes së Bankës së Bashkimit Evropian, Direktivën e Bashkimit Evropian mbi Marrëveshjet e Kolateralit Financiar, Atributet kryesore të Bordit të Stabilitetit Financiar të Regjimeve të Zgjidhjes Efektive për Institucionet Financiare dhe Parimet e UNIDROIT mbi Funkcionimin e Dispozitave të Kompensimit.

sigurimeve rregullohet edhe nga Ligji Nr. 8901, datë 23 maj 2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar. Meqë ligji 8901/2002 është shfuqizuar, për shkak të ligji të ri, Neni 182 i referohet edhe LF-së, duke krijuar kështu një lloj mospërputhje të dy normave ligjore.

Për sa i përket rasteve të paaftësisë paguese në industrinë bankare, këto të fundit rregullohen me ligjin nr. 133/2016 “Për rikuperimin dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë” i cili përbën kuadrin ligjor për rikuperimin dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka dhe degët e bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj përcakton rregullat, procedurat dhe instrumentet e përdorura për rikuperimin dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka dhe parashikon kompetencat e Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve të tjera lidhur me këtë çështje. Bankës së Shqipërisë i janë dhënë disa instrumente ligjore për të ndërhyrë në një fazë mjaft të hershme, në rastet e vështirësive financiare të bankave, duke zvogëluar gjithmonë ndikimin në sistemin financiar, kreditorët dhe ekonominë në përgjithësi. Instrumentet përkatëse i japin Bankës së Shqipërisë mundësinë për të ruajtur një qëndrueshmëri në mbledhjen e depozitave dhe kryerjen e transaksioneve të pagesave, duke shitur pasuritë e bankave dhe duke mbuluar humbjen me qëllim shmangien e destabilizimit të tregut financiar dhe zvogëlimin e kostos që u ngarkohet taksapaguesve.

Në tregjet financiare jo-bankare, Parlamenti Shqiptar ka miratuar së fundmi dy ligje kryesore: ligjin ‘Për Tregjet e Kapitalit’ më 14 maj të vitit 2020 dhe ligjin për sipërmarrjet e investimeve kolektive, i cili hyri në fuqi më 20 qershor të vitit 2020. Këto ligje të reja përcaktojnë rregulla uniforme për fondet e investimeve, organizimin dhe funksionimin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive për Letrat me Vlerë të Transferueshme (“SIKLV”) dhe përcakton e përmirëson kuadrin aktual ligjor duke iu referuar dinamikës së zhvillimit të tregut të brendshëm të kapitalit.

Ligji për tregjet e kapitalit promovon zhvillimin dhe integritetin e tregjeve të kapitalit, rrit transparencën dhe mbrojtjen e investitorëve me anë të standardeve më të larta. Çdo ligj përmban rregullore lidhur me skenarët e falimentimit të shoqërive administruese që kanë në portofolin e tyre letra me vlerë dhe fonde të tjera investimi. Këto ligje përcaktojnë që shoqëritë administruese likuidohen dhe kalojnë nëpër procedura normale falimentimi të përfshira në LF-në. Fondet dhe letrat me vlerë të administruara janë të ndara nga masa e falimentimit dhe nuk janë pjesë e procesit të falimentimit, i cili sipas këndvështrimit tonë është në përputhje me përjashtimin e përgjithshëm që parashikohet në LF-në. Megjithatë, ky përfundim nuk duhet të konsiderohet i mirëqenë. Meqenëse ligji për tregjet e kapitalit është prezantuar vetëm së fundmi, zbatueshmëria e dispozitave të falimentimit brenda kuadrit të një procedure të paaftësisë paguese duhet ende të testohet.

VII.III. Konkluzione

Ekonomitë duhet të përpiqen të mbajnë të përditësuar kuadret e tyre ligjore të falimentimit në mënyrë që të trajtojnë më mirë sfidat aktuale. LF-ja ka synuar të modernizojë sistemin e falimentimit në Shqipëri, duke siguruar mbrojtje të mëtejshme për të drejtat e kreditorëve, si dhe lehtësime të përkohshme dhe mjete të dobishme ristrukturimi për debitorët. Ajo gjithashtu ka synuar të zvogëlojë afatet kohore për procedurat e falimentimit të shqyrtuara nga gjykatat, duke rritur kështu efikasitetin dhe uljen e kostove.

Megjithëse nuk nënkupton se ofron një shpjegim shterues të secilit nen të sistemit të ri të falimentimit të krijuar përmes LF-së, ky Komentar është përpjekur të kontribuojë në kuptimin e rregullave dhe procedurave të LF-së. Si të tilla, seksionet e ndryshme të këtij raporti i kanë drejtuar lexuesit në aspektet kryesore ligjore të procedurave të falimentimit në vend. Si një tekst hyrës, mjetet në këtë raport kanë synuar të ndihmojnë lexuesit të kuptojë procedurat e falimentimit. Lexuesit e interesuar shpresojmë se do ta gjejnë këtë komentari si platformë të rëndësishme nga ku mund të fillojnë hulumtimet e mëtejshme mbi këtë temë.

Projekti zbatohet nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore (WBG) dhe me mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:

Z. Igor Matijevic

Menaxher Rajonal për Programin

e-Mail: imatijevic@ifc.org

Znj. Irena Gribizi

Koordinatorë e Projektit për Shqipërinë

e-Mail: igribizi1@ifc.org

Në partneritet me:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për
Çështjet Ekonomike SECO